

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6310
E hënë, 11 maj 2021
çmimi 0.40 €

Mavraj: Dmth.,
paskemi ushtri! | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRITIKOHET QASJA E BASHKIMIT EVROPIAN NDAJ REPUBLIKËS SË KOSOVËS | FAQE 4-5

BE-ja PO TREGOHET NEGLIZHENTE NË RAPORT ME KOSOVËN



Shoqëria civile dhe liderët institucionalë kanë kritikuar qasjen e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës. Ata kanë vlerësuar se BE-ja po tregon neglizhencë në raport me rrugën e Kosovës drejt

integritimeve evropiane, duke u fokusuar kryesisht në çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Njohësit e integritimeve evropiane kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova ka mbetur prapa në

agjendën integruese për shkak të problemeve të brendshme dhe për shkak të neglizhencës së BE-së si dhe mosnjohjes së Kosovës nga pesë vendet anëtare të bllokut

PREMTIMI I ALBIN KURTIT, A MUND TA PADISË KOSOVA SERBINË PËR GJENOCID?



Kryeministri Albin Kurti është shprehur i vendosur që gjatë mandatit të tij qeverisës do ta padisë shtetin serb për gjenocid në Kosovë gjatë luftës së fundit. Mirëpo njohësit e çështjeve juridike kanë shprehur skepticizëm në lidhje me një padi të tillë. Sipas tyre,

edhe nëse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do ta padisë Serbinë për gjenocid, kjo mund të sillte telashe të tjera. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se çdo veprim i njëanshëm i Kosovës pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në do të kishte kundërefekt | FAQE 5

OPINION

STRATEGJIA E SHËRBIMIT
SEKRET SERB PËR TA
SHKATËRRUAR STRUKTURËN
E UÇK-SË PAS VITIT 2000 E
KËNDEJ (1) | F. 11

Faton
B. MEHMETAJ



AKTUALE



BIK-u S'DO TA ORGANIZOJË
PRITJEN TRADICIONALE
TË FESTËS SË FITËR BAJRAMIT,
SHKAK PANDEMIA | F. 7

NESËR VIJNË NË KOSOVË EDHE
38 400 VAKSINA KUNDËR
COVIDIT | F. 7

TELEVIZIONI PUBLIK GJERMAN
SHKRUAN PËR MBYLLJEN E
GAZETAVE NË KOSOVË | F. 10

EKONOMI

KOSOVA DHE IZRAELI
PAJTOHEN PËR THELLIMIN E
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK | F. 9

QEVERIA FAVORIZON SKEMAT
SOCIALE | F. 9

GASTRONOMËT PARALAJMËROJNË
PROTESTA TË "ASHPRA" NËSE
NUK ZGJATET ORARI I PUNËS | F. 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

HRW-ja bën thirrje për zbatimin e Konventës së Stambollit

NJU-JORK, 10 MAJ - Organizata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Human Rights Watch (HRW), u ka bërë thirrje vendeve anëtare të Këshillit të Evropës që t'i forcojnë përpjekjet për ta luftuar dhunën ndaj grave duke ratifikuar dhe zbatuar Konventën e Stambollit që synon parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. "Anëtarët e Këshillit të Evropës duhet të tregojnë se janë seriozë në lidhje me përparësinë e sigurisë dhe mirëqenies së të gjitha grave dhe vajzave duke zbatuar Konventën e Stambollit", është thënë në deklaratën e HRW-së.

Konventa e Stambollit është ratifikuar nga 33 vende nga 47 sa janë anëtare të Këshillit të Evropës. Dymbëdhjetë të tjerë e kanë nënshkruar, por ende nuk e kanë ratifikuar konventën, përfshirë Ukrainën e cila e

nënshkroi atë më 2011.

Azerbajxhani dhe Rusia janë vendet e vetme anëtare të Këshillit të Evropës që nuk e kanë nënshkruar traktatin.

HRW-ja ka paralajmëruar se disa qeveri janë tërhequr ose kanë kërcënuar se do të tërhiqen nga traktati, ndërsa të tjerët kanë refuzuar ta ratifikojnë atë pavarësisht nga "raportet e rritura të dhunës në familje" gjatë masave të izolimit për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit.

"Pandemia Covid-19 ka nxjerrë në pah faktin se dhuna ndaj grave është një nga abuzimet më të gjera të të drejtave të njeriut dhe një kërcënim ditor për jetën dhe shëndetin e grave dhe vajzave në të gjithë botën", ka thënë Hillary Margolis, studiuese në HRW.

Sipas organizatës, Konventa e Stambollit "vendos standarde të fuqishme, ligjrisht të

detyrueshme për qeveritë për ta parandaluar dhunën ndaj të gjitha grave dhe vajzave dhe për të kërkuar përgjegjësi ndaj abuzuesve".

HRW-ja ka vënë në dukje se traktati urdhëron mbrojtje nga format e dhunës që shpesh nuk përfshihen në legjislacionin kombëtar siç janë ngacmimi seksual ose martesë e detyruar dhe kërkon mbrojtje për të gjitha viktimat e dhunës - pavarësisht nga mosha, etnia dhe orientimi seksual.

Turqia në fillim të këtij viti vendosi të tërhiqet nga konventa. HRW-ja ka thënë se vendimi paraqet "një pengesë për të drejtat e grave në vend".

Në vitin 2020 ministri i drejtësisë i Polonisë njoftoi se do të procedojë tërheqjen nga konventa, ndërsa parlamentet në Hungari dhe Sllovaki bllokuan ratifikimin e saj.

Gjykata Kushtetuese e



Bullgarisë vendosi më 2018 që përdorimi i "gjinisë" nga konventa e bën atë antikushetuese. "Politikanët dhe grupet konservatore kanë pretenduar gabimisht se konventa kërcënon familjet 'tradicionale' dhe promovon homoseksualitetin", kanë thënë nga HRW-ja.

Sipas organizatës, disa qeveri "pretendojnë se ligjet e brendshme sigurojnë mbrojtje për gratë dhe përgjegjësi", ndërsa "shumë të mbijetuar vazhdojnë të përballen me stigmatizim, qëndrime shpërfillëse nga autoritetet dhe presionin shoqëror për të heshtur".

Borrelli: Duam t'i ofrojmë Ballkanit Perëndimor një perspektivë më të mirë evropiane



BRUKSEL, 10 MAJ - Ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) të hënën kanë diskutuar në Bruksel rreth një angazhimi më të fortë politik të BE-së me partnerët në Ballkanin Perëndimor.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikën e jashtme dhe sigurinë dhe nënkryetari i Komisionit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se situata në Ballkanin Perëndimor është një nga temat më të rëndësishme e cila do të

diskutohet sot. "Duam të kemi një pasqyrë të re të situatës në Ballkanin Perëndimor dhe të shohim se si mund të përfshihemi më shumë në rajon", ka thënë Borrelli.

Borrelli ka theksuar rëndësinë e Ballkanit Perëndimor për BE-në, duke shtuar se gjatë takimit do të diskutohen mënyrat "për t'i ofruar rajonit një perspektivë më të mirë dhe më të fortë evropiane". Ministrat e jashtëm të BE-së do të takohen përsëri edhe sot (e mbartë) në formatin

"çështje të përgjithshme", kurse krerët e shteteve ose qeverive do të diskutojnë në qershor se si t'i integrojnë marrëdhëniet me Ballkanin Perëndimor në prioritetet strategjike të BE-së.

Borrelli ka njoftuar se do të diskutojë për ndryshimet klimatike dhe për bashkëpunimin me ShBA-në në këtë fushë si dhe për marrëdhëniet me Rusinë, situatën në Liban dhe shtyrjen e zgjedhjeve palestineze të planifikuara për 22 maj.

Mbi 1 400 emigrantë arrijnë në jug të Italisë

ROMË, 10 MAJ - Pesëmbëdhjetë anije të mbushura me mijëra emigrantë zbarkuan në ishullin jugor italian të Lampedusa. Më shumë se 1 400 njerëz kanë zbritur nga anijet në ishullin Mesdhe, një nga pikat kryesore për emigrantët e paligjshëm që përpigjen të hyjnë në Evropë. Autoritetet kanë deklaruar se numri i tyre mund të rritet gjatë ditëve në vijim për shkak edhe të përmirësimit të motit. Rreth 11 000 emigrantë kanë zbarkuar në ishull që nga fillimi i vitit. Kjo është mbi shifrën e vitit të kaluar prej 4 105 për të njëjtin periudhë, raporton agjencia e lajmeve "Reuters".

Numri i përgjithshëm është ende poshtë nga 2015, kur qindra mijëra emigrantë bënë kalimin e rrezikshëm të detit për në Evropë, shumë prej tyre duke ikur nga varfëria dhe konfliktet në Afrikë dhe Lindjen e Mesme. Por çështja ende ndan ashpër qeveritë evropiane dhe ka nxitur ndjenjat anti-emigrim në të gjithë kontinentin. Matteo Salvini, kreu i partisë së ekstremit të djathtë, i ka bërë thirrje kryeministrit Mario Draghi të merret me këtë çështje. "Me miliona italianë që përballen me vështirësi ne nuk mund të kujdesemi për mijëra emigrantë të paligjshëm", ka shkruar ai në



llogarinë e vet "Twitter". Të gjithë emigrantët janë zhvendosur në të nxehtë", qendra e ashtuquajturën "pika e emigrantëve në ishull."

Mavraj: Dmth., paskemi ushtri!

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), së bashku me Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), kanë zbarkuar në Kuvajt në kuadër të një misioni paqeruajtës. Me këtë rast, botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka thënë se Kosova moti ka ushtri falë djemve trima të cilët, sipas tij, kanë duruar dhe po durojnë me dinjitet urrejtjen dhe goditjet me brutale nga kundërshtarët historikë qysh gjatë luftës e deri sot.

Mavraj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është krenar me ushtrinë e Kosovës e cila me urti e maturi është rreshtuar me ushtrinë amerikane. "Jam krenar të jam gjithmonë, deri të vdes, në mbrojtje të lirisë që e solli po kjo ushtri, e shpirtit perëndimor, që tërhoqi me urti

e maturi në anën tonë ushtrinë krenare amerikane qysh gjatë luftës e deri më sot. Këto dy ushtri të bashkuara sot janë me mision në Kuvajt!", ka shkruar Mavraj.

Postimi i plotë i Mavrajt:

Dmth., paskemi ushtri!

Moti kemi ushtri falë djemve trima të cilët kanë duruar dhe po durojnë me dinjitet urrejtjen dhe goditjet me brutale nga kundërshtarët historikë qysh gjatë luftës e deri sot.

Jam krenar të jam gjithmonë, deri të vdes, në mbrojtje të lirisë që e solli po kjo ushtri, e shpirtit perëndimor, që tërhoqi me urti e maturi në anën tonë ushtrinë krenare amerikane qysh gjatë luftës e deri më sot. Këto dy ushtri të bashkuara sot janë me mision në Kuvajt!



Gjenden kafkat e dy personave në Kizhevak



PRISHTINË, 10 MAJ - Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës, Arsim Gërxhaliu, ka bërë me dije se gjatë gërmimeve të fundit në Kizhevak të Serbisë janë gjetur kafkat e dy personave. Ai ka reguar se gjatë së martës

pritet të bëhet tërheqja e tyre në mënyrë që t'u merren mostrat për test të ADN-së. "Deri më tani në sipërfaqe, pas largimit të një shtrese të dheut dhe të gurëve, kanë dalë dy kafa dhe minimum dy persona për të cilët duhet të

bëhet tërheqja e tyre dhe të bëhet inspektimi mjeko-ligjor dhe të merren mostrat për ADN", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka deklaruar se në këtë vend do të gërmohet edhe në ditët në vijim. "Të shtunën ka përfunduar punën ekipi i

parë, sot në orën 07:00 është nisur ekipi i dytë, gjithashtu prej tre anëtareve, do të punojnë deri të shtunën, pra gjashtë ditë në javë punohet. Gjithsesi do të kemi punë edhe në javën në vijim e, varësisht prej problematikave

që mund të na lindin në terren, mund të ndodhë që të zgjatet derisa të përfundojë tërësisht", ka deklaruar ai për "EO".

Gërxhaliu ka deklaruar se nuk dihet numri i trupave që dyshohet se mund të jenë aty.

Ministria e Mbrojtjes do të ketë buxhet mbi 100 milionë euro

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës nga viti i ardhshëm do të ketë buxhet mbi 100 milionë euro. Kështu është paraparë në Kornizën

Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024 e cila është miratuar në mbledhjen e 10-të të qeverisë. "Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024 e

miratuar në mbledhjen e 10 të qeverisë parasheh që, duke filluar nga viti i ardhshëm, buxheti vjetor i Ministrisë së Mbrojtjes për herë të parë të jetë mbi 100 milionë euro. Qeveria

Kurti ka për prioritet që të kemi një forcë të gatshme për mbrojtjen e vendit dhe për të kontribuar në paqen dhe sigurinë globale", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.





KRITIKOHET QASJA E BASHKIMIT EVROPIAN NDAJ REPUBLIKËS SË KOSOVËS

BE-ja po tregohet neglizhente në raport me Kosovën

Shoqëria civile dhe liderët institucionalë kanë kritikuar qasjen e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës. Ata kanë vlerësuar se BE-ja po tregon neglizhencë në raport me rrugën e Kosovës drejt integritimeve evropiane, duke u fokusuar kryesisht në çështjen e dialogut Kosovë - Serbi. Njohësit e integritimeve evropiane kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova ka mbetur prapa në agjendën integruese për shkak të problemeve të brendshme dhe për shkak të neglizhencës së BE-së si dhe mosnjohjes së Kosovës nga pesë vendet anëtare të bllokut

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

Prishtinë, 10 maj - Njohësit e integritimeve evropiane kanë kritikuar qasjen e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës. Ata kanë deklaruar se BE-ja po tregon neglizhencë në raport me rrugën e Kosovës drejt integritimeve evropiane. Njohësi i integritimeve evropiane, Bardhyl Hasanpapaj, ka deklaruar për "Epokën e re" se BE-ja, duke u fokusuar vetëm në çështjen e dialogut me Serbinë, po e anashkalon Kosovën në fusha të tjera. "BE-ja po tregon një neglizhencë në raport me Kosovën duke e përqendruar raportin kryesisht në çështjen e dialogut Kosovë - Serbi, duke mos bërë sa duhet në fushat e tjera që do të ishin me rëndësi për qytetarët e Kosovës. Pra, Kosova ka ngelur prapa në agjendën integruese si për shkak të problemeve të brendshme, po ashtu edhe për shkak të neglizhencës së BE-së dhe shteteve anëtare në mënyrën si po e trajtojnë Kosovën", ka thënë ai.

Hasanpapaj ka vlerësuar se kjo neglizhencë e BE-së karshi

Kosovës po ka ndikim në rritjen e mosbesimit të qytetarëve të Kosovës ndaj BE-së. "Po, në Kosovë më të drejtë ka filluar të vërehet një ndjenjë mosbesimi si ndaj institucioneve të BE-së ashtu edhe ndaj qasjes që disa vende kanë treguar në raport me Kosovën. Kosova është shumë e vogël, si popullsi, për të përbërë një shtetësim kaq të madh për BE-në në çështjen e liberalizimit të vizave! Rreziku nga një liberalizim i mundshëm i vizave për Kosovën që BE-ja tenton ta plasojë jo vetëm që është i padrejtë por, në fakt, është edhe shumë qesharak. Kosova ka përmbytur të gjitha kushtet, ndërkohë që BE-ja do të duhej tashmë ta përfshinte edhe Kosovën në kuadrin e shteteve që lëvizin pa viza në zonën Shengen!", ka thënë ai.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Instituti EPIK, Demush Shasha, për mosliberalizim të vizave ka fajësuar edhe institucionet e Kosovës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se për arsye të brendshme politike Kosova ka humbur rastin e mirë për këtë proces në vitin 2016. "Sa i përket procesit liberalizimit vizave, Kosova ka humbur shumë kohë

për arsye tërësisht politike. Ne kemi humbur momentumin pozitiv që ekzistonte në vitin 2016 për shkak mungesës së konsensusit të spektrit politik lidhur me çështjen e demarkacionit i cili u ka kushtuar qytetarëve të Kosovës tani pothuaj pesë vjet izolim. Në vitin 2016 BE-ja i hapi derën Kosovës që të jetë pjesë e Zonës Shengen, por skena politike e Kosovës refuzoi këtë ofertë duke mbajtur kështu qytetarët e Kosovës të vetmit në Ballkanin Perëndimor pa të drejtën e lëvizjes së lirë", ka thënë ai, duke i përmendur edhe ngecjet e Kosovës në këtë drejtim. "Ndërkohë, Kosova dështoi të ndërtojë një sistem të pavarur të drejtësisë i cili do të ishte në gjendje të shënojë progres në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë. Rrjedhimisht, sot jemi me një mjedis kompleks ku janë së paku katër faktorë të cilët janë duke penguar liberalizimin e vizave për Kosovën", ka thënë ai. Shasha ka bërë me dije se pakënaqësia e liderëve të institucioneve karshi BE-së është reflektim i pakënaqësisë së qytetarëve. "Sidoqoftë, duhet kuptuar se BE-ja ka trajtuar Kosovën të barabartë me të gjitha

vendet e tjera të rajonit. Pra, Kosova ka ngritur marrëdhënie kontraktuale për anëtarësim në BE. Kosova ka lansuar procesin e liberalizimit të vizave. Kosova është përfituesja e dytë më e madhe në rajon nga ndihma e BE-së për kokë banori. Po ashtu, Kosova është pjesë e çdo nisme rajonale në nivelin e barabartë me vende të tjera të rajonit. Procese të rëndësishme, sikur ai i pavarësisë energjetike, janë mundësuar falë mbështetjes së BE-së. Natyrisht duhet kuptuar se edhe BE-ja ka kufizimet e veta për të ndërvepruar me Kosovën duke pasur parasysh mosnjohjen nga pesë vende të BE-së", ka thënë Shala.

Liderët institucionalë kërkojnë që Evropa t'i hapë dyert për Kosovën

Krerët shtetërorë në Kosovë, në Ditën e Evropës, kanë bërë thirrje për liberalizim të vizave. Ata kanë vlerësuar se Kosova ka përmbytur të gjitha kriteret për këtë proces dhe se BE-ja po vonohet në këtë drejtim. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se Kosova është një vend paqedashës dhe me orientim proevropian. "Besueshmëria e BE-së dhe e institucioneve të saj varet nga mbajtja e fjalës në lidhje me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Kosova, ndërkaq, duhet t'i bëjë përgatitjet e nevojshme për aplikim për status të shtetit kandidat në momentin e vulltshëm", ka deklaruar ajo.

Thirrje të njëjtë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës ka bërë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. "Edhe pas kaq vjetësh Bashkimi Evropian është treguar i vonuar në proceset e integritimit të Kosovës brenda familjes evropiane dhe kjo ëndërr gjithnjë e më shumë po shndërrohet në një zhgënjim kolektiv për qytetarët e shtetit tonë. Sepse Dita e Evropës e gjënë Kosovën jo vetëm pa statusin e kandidatit, por edhe pa liberalizim të vizave, ndërsa qytetarët e saj në një getoizim të pashembullt. Përveçse diskriminim dhe padrejtësi e madhe, kufizimi i lirisë së lëvizjes është edhe shmangie nga parimet e një Evrope pa kufij", ka shkruar Konjufca në profilin e tij në "Facebook".

Ndërsa kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka vlerësuar se qeveria aktuale e ka lëkundur besimin e qytetarëve të Kosovës në BE. "Edhe 9 maji i vitit 2021, Dita e Evropës, e gjënë Kosovën pa liberalizim të vizave, pa status të kandidatit dhe, fatkeqësisht, pa rrugë të qartë për të ardhmen evropiane. Qeveria e sotme, opozita e dikurshme, ka lëkundur besimin e qytetarëve të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe ka dëmtuar shumë herë progresin e arritur. Po ashtu, edhe vetë BE-ja është vonuar për përmbytur dhe premtimeve dhe obligimeve karshi qytetarëve të Kosovës, posaçërisht për liberalizimin e vizave", ka shkruar Hoxhaj në profilin e vet në "Facebook".

Premtimi i Albin Kurtit, a mund ta padisë Kosova Serbinë për gjenocid?

Kryeministri Albin Kurti është shprehur i vendosur që gjatë mandatit të tij qeverisës do ta padisë shtetin serb për gjenocid në Kosovë gjatë luftës së fundit. Mirëpo njohësit e çështjeve juridike kanë shprehur skepticizëm në lidhje me një padi të tillë. Sipas tyre, edhe nëse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do ta padisë Serbinë për gjenocid, kjo mund të sillte telashe të tjera. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se çdo veprim i njëanshëm i Kosovës pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në do të kishte kundërefekt



PRISHTINË, 10 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është i vendosur që gjatë mandatit të tij qeverisës ta padisë Serbinë për gjenocid në Kosovë gjatë periudhës së luftës. Këtë pikë kryeministri i Kosovës e ka përfshirë në programin e vet qeveritar duke thënë se “çështja e padisë për gjenocid para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) do të jetë një nga përparësitë e punës së tij gjatë mandatit qeverisës”. “Ne jemi të bindur që Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë në luftën e fundit tek ne dhe kjo e meriton një padi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës e ka përgatitjen e saj obligim ndaj historisë sonë, ndaj qytetarëve që kanë plagët e hapura dhe, qe besa, edhe ndaj ardhmërisë sonë, që kërkon një shtet demokratik, një shtet të drejtë në të cilin dihet qartë se kush është agresori e kush është viktima”, kishte thënë kryeministri Kurti pas miratimit të programit qeveritar.

Kryeministri Kurti kishte thënë se përgatitjet për padi “janë gjigante sepse një rast i tillë as nuk guxon, as nuk duhet e as nuk mund të humbet”.

Vuçiqi: Padia, kërcënim dhe as nuk duhet provuar

Paralajmërimi i Qeverisë së Kosovës për padi për gjenocid ndaj Serbisë ka nxitur reagimin e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë

se “Kosova nuk mund ta bëjë një gjë të tillë meqë nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara”. Madje ai i ka rekomanduar Kosovës që mos të provojë ta bëjë një gjë të tillë, duke e cilësuar edhe si kërcënim. “Po kërcënoni Serbinë me gjyq për gjenocid? Mund ta realizoni këtë vetëm përmes një shteti tjetër, që është Shqipëria, e kjo do të thotë bashkim me Shqipërinë. U kërkoj shqiptarëve të Kosovës që të mos e bëjnë këtë”, ka thënë Vuçiqi.

Ekspertët: Pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në padia do të kishte kundërefekt

Njohësit e çështjeve juridike kanë shprehur skepticizëm për nismën e Qeverisë së Kosovës për ta paditur Serbinë për gjenocid në Kosovë, pikërisht duke përmendur faktin që Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe formalisht nuk mund ta bëjë këtë. Kështu i ka thënë “DW”-së Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD).

“Në aspektin formal, Kosova nuk ka kapacitet për të ushtruar padi për gjenocid ndaj Serbisë, padi e cila do të konsiderohej e pranueshme nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Shtetndërtimi i Kosovës është ngushtë i lidhur dhe i varur nga mbështetja dhe ndihma e partnerëve ndërkombëtarë, andaj edhe çdo veprim në këtë drejtim duhet ta ketë vëmendjen

e tyre, koordinimin dhe bashkëpunimin. Çdo veprim i njëanshëm i Kosovës pa pajtim me ShBA-në dhe BE-në, kam frikë se do të kishte kundërefekt dhe do ta vinte Kosovën në një situatë të pafavorshme”, ka thënë Ehat Miftaraj. Sipas tij, edhe nëse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do ta padisë Serbinë për gjenocid, kjo mund të sjellë telashe të tjera. “Në aspektin formal Shqipëria ka të drejtë të ushtrojë padi njësoj si çdo shtet anëtar i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, por se shtetet e tjera serioze në këtë rast do të hezitonin të ndërmerren një hap të tillë duke marrë për bazë lidhjen shumë të afërt dhe vëllazërore që ka Shqipëria me Kosovën”, ka thënë ai.

Mundësia pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Një njohës tjetër i çështjeve juridike, Afrim Hoti, profesor në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se ekziston një mundësi që pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë entitetet e caktuara mund të ngrenë padi, por të cilat paraprakisht obligohen t’u nënshtrohen rregullave dhe procedurave të caktuara të kësaj gjykate. “Është një deklaratë që

deponohet në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë përmes së cilës Republika e Kosovës, si shtet që nuk është anëtar i OKB-së, deklaron që e pranon autoritetin e gjykatës dhe i pranon vendimet që jepen nga GjND-ja. Këto janë raste shumë të rralla, që njihen si të tilla që statuti i gjykatës e lejon një mundësi të tillë, sikundër që edhe entitetet që kanë pozicion pak a shumë të ngjashëm si Kosova janë të rralla. Juridikisht, palë para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë vetëm shtetet e pavarura dhe të cilat njëkohësisht janë pjesë e OKB-së”, ka deklaruar Hoti.

Kosova mund ta shfrytëzojë këtë mundësi për të ngritur padi për gjenocid ndaj Serbisë por, sipas Hotit, “duhet bërë një dallim elementar ndërmjet deklaramëve politike dhe deponimit formal”, që nuk do të thotë që është përmbyllur procesi. “Ai do të mund të konsiderohet si një veprim juridik, mirëpo për vërtetimin e ekzistimit të krimit duhet të deponohen edhe shumë fakte të tjera për t’i pranuar gjykata”, ka thënë Hoti. Shqiptarët në Kosovë e cilësojnë gjenocid fushatën e forcave serbe të sigurisë gjatë luftës së viteve 1998-1999, ku u vranë mbi

10 mijë veta, mijëra të tjerë llogariteshin të zhdukur, ndërsa mbi 800 mijë shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Në vitin 1999 Kroacia kishte ngritur padi ndaj Serbisë në GjND për gjenocid gjatë luftës së viteve 1991-1995. Në vitin 2010 Serbia kishte paraqitur një kundërpadi ndaj Kroacisë, duke thënë se rreth 200 mijë serbë etnikë janë zhvendosur, kur Kroacia kishte filluar operacionin ushtarak në kërkim të territoreve të pretenduara prej saj. E në vitin 2015 GjND-ja vendosi që as Serbia e as Kroacia nuk kanë kryer gjenocid ndaj njëra-tjetrës. Ndërkaq, sa i përket rastit të Bosnjës e Hercegovinës, përkatësisht rastit “Srebrenica”, në vitin 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë kishte konstatuar se vrasjet e rreth 8 000 myslimanëve të Bosnjës në Srebrenicë kanë përbërë gjenocid, por kjo gjykatë ishte shprehur se Serbia nuk e kishte parandaluar gjenocidin, por kishte thënë se edhe se nuk kishte prova të mjaftueshme, Serbia kishte përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë. Në vitin 2017 Bosnja e Hercegovina kishte kërkuar rishikimin e këtij vendimi, por GjND-ja e pati hedhur poshtë këtë kërkesë./DW/

Kryediploti kroat i kërkon BE-së heqjen e vizave për Kosovën

BRUKSEL, 10 MAJ - Ministri i Jashtëm kroat, Gordan Grliq Radman, i bëri thirrje Bashkimit Evropian që të angazhohet më shumë politikisht dhe strategjikisht në Ballkanin Perëndimor. Para debatit të Këshillit të BE-së mbi Ballkanin Perëndimor, ai ka vënë në dukje se investimi në rajon, që është

“më i afërt me BE-në”, është në të njëjtën kohë investim në stabilitetin dhe sigurinë e Evropës. “Partnerët tanë në rajon duhet të punojnë për transformimin demokratik, për të drejtat e njeriut dhe për sundimin e ligjit. Ky është çelësi për rrugën e tyre në BE”, ka thënë Radmani. Më tutje, ai ka bërë

thirrje për hapjen e bisedimeve të pranimit me Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë, si dhe për liberalizimin e vizave për Kosovën. “Mali i Zi duhet të mbetet i përkushtuar në rrugën e BE-së dhe Serbia duhet të përqendrohet në reformat dhe kapërcimin e trashëgimisë së të kaluarës”, ka thënë ai.



Zinxhiri i drejtësisë që mbron zyrtarët e akuzuar për korrupsion

PRISHTINË, 10 MAJ - Rreth një muaj më parë Rrahim Hashimi publikoi një video në profilin e vet në rrjetin social "Facebook" duke hapur një shampanjë, me mbishkrimin "Drejtësia triumfoi", duke festuar kështu lirimimin e tij nga akuzat e Prokurorisë, prej të cilave ishte dënua për mashtrim me tre vjet e nëntë muaj burgim efektiv.

Lirimi i tij ka ardhur pas vendimit të Gjykatës Supreme, që konstatoi se veprimet hetimore dhe aktakuza ndaj Rrahim Hashimit janë ndërmarrë pasi në këtë lëndë ka arritur afati i parashkrimit relativ. Për shkak se Prokuroria nuk e ka kryer punën e saj në kohën e paraparë me ligj, Rrahim Hashimi mbetet i paprekshëm nga ligji, pasi amnistohet për shkak të vjetërsimit të lëndës.

Në një intervistë për emisionin "Iustitia", që është bashkëprodhim i "Radios Evropa e Lirë" dhe "Betimit për Drejtësi", Rrahim Hashimi ka thënë se shteti ka rënë në lajthitje të disa zyrtarëve të vet, në veçanti të zyrtarëve policorë, të cilët, sipas tij, kanë filluar ndjekjen penale në mënyrë të kundërligjshme. "Vepra e aluduar që kinse është kryer në vitin 2011, e që ka qenë vetëm një ndërmjetësim legal, absolutisht nuk ka pasur asgjë jolegale, ka dashur të kamuflohet kinse me vjetërsim të lëndës sepse edhe ata e kanë ditur se nuk ka ekzistuar asgjë në të vërtetë. Në këtë rast nuk ka pasur parashkrim të asnjë veprë penale, ka pasur një tentativë për ta mbuluar një krim, dhe ai krim është shantazhi dhe përbaltja e figurave politike dhe mua më kanë përdorur si trampolinë, në këtë rast për shkak të afërsisë time me PDK-në, por faktikisht me zotën Xhavit Haliti dhe zotën Kadri Veseli nuk kam pasur njohje personale", ka thënë Hashimi.

Rrahim Hashimi së bashku me Kadri Rexhepin ishin akuzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, më 21 mars 2018, për veprën penale "mashtrim" në bashkëkryerje. Sipas Prokurorisë, prej 30 dhjetorit të vitit 2011 deri më 24 korrik 2012 Rrahim Hashimi, Kadri Rexhepi dhe një i pandehur tjetër, që gjendet në arrati, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve për të përfituar kundërligjshëm dobi pasurore, e kanë vënë në lajthitje të dëmtuarin, Faton Dalladakun. Sipas prokurorisë, ata janë prezantuar rrejshëm para

Dalladakut se janë të afërm të Kadri Veselit dhe Xhavit Halitit, të dy zyrtarë të lartë të Partisë Demokratike të Kosovës, e cila asokohe ishte në pushtet, kinse për ta ndërmjetësuar blerjen e Qendrës Kardiake të Kosovës Sh.PK në Prishtinë. Duke bërë prezantime të rrejshme, sipas Prokurorisë, ata kanë arritur që nga i dëmtuari Faton Dalladaku të marrin 290 mijë e 810 euro.

Shukri Buja, i vetmi i dënua me burgim efektiv

I vetmi politikan i profilit të lartë i cili është dënua me burgim efektiv prej tre vjetësh për korrupsion është Shukri Buja, ish-kryetar i Komunës së Lipjanit. Por, edhe lënda ndaj tij tashmë është në prag të parashkrimit për shkak të "lojës së pingpongut" nga sistemi i drejtësisë. Aktakuza ndaj tij ishte ngritur nga Prokuroria Speciale më 13 shkurt 2017. Astrit Haraqija, ish-ministër i Kulturës i dënua për korrupsion me dy vjet burgim me kusht, është liruar nga aktakuza për korrupsion për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Këto janë vetëm disa prej rasteve të aktakuzave më reprezentative të korrupsionit ku janë të akuzuar zyrtarë të ndryshëm për vepra penale të korrupsionit, për të cilat sistemi i drejtësisë ka dështuar të nxjerrë vendime gjyqësore përfundimtare.

Zyrtarët e akuzuar për korrupsion për këto raste kanë mbetur pa mundësinë që të përballen me gjykim të drejtë në kohë të arsyeshme, rrjedhimisht shumë prej tyre, të cilët kanë mundur të jenë të korruptuar, kanë përfituar amnisti të përjetshme.

Si po amnistohen zyrtarët e akuzuar për korrupsion?

Mënyra e trajtimit të rasteve të korrupsionit në Kosovë është në fokus të monitorimit nga organizatat vendore dhe faktori ndërkombëtar. Arrita Rezniciq nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka thënë se sistemi i drejtësisë qëllimisht ka ndërtuar praktika, përmes të cilave, amnistohen zyrtarët e akuzuar për korrupsion. "Zvarritjet dhe dështimet e vazhdueshme në procedurë penale, në fund dërgojnë në përfundimin e afateve ligjore, pra lëndët parashkruhen apo



vjetërsohen dhe rrjedhimisht zyrtarët e akuzuar për korrupsion, amnistohen për ato vepra përjetësisht. Dëmet që shkaktohen nga këto veprime janë shumëdimensionale sepse të korruptuarit nuk ndëshkohen, të dëmtuarit nuk kompensohen dhe në fund humbet besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë", ka thënë Rezniciq.

Institucionet e drejtësisë në Kosovë kritikohen se nuk janë duke përmbushur obligimet ligjore për të hetuar, ndjekur dhe gjykuar rastet e korrupsionit. Sipas gjetjeve të IKD-së, vetëm në tre vjetët e fundit veprat penale të korrupsionit janë parashkruar në 16 raste të mëdha të korrupsionit, në të cilat zyrtarët e akuzuar janë amnistuar. Përgjegjësinë për dështimet në rastet e korrupsionit, institucionet e drejtësisë ia hedhin njëra-tjetrës.

Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, thotë se me rastin e ngritjes së aktakuzës ata e kryejnë obligimin e tyre. "Natyrisht, instituti i parashkrimit është institut që ndëshkon institucionet. Tash kemi parashkrimin e ndjekjes dhe parashkrimin e ekzekutimit të dënimit. Sa i përket parashkrimit të ndjekjes, varet se kur, për shembull, është identifikuar kryerja e një veprë penale, nëse ajo vepër penale është identifikuar me kohë, rasti është proceduar në prokurori dhe është parashkruar, natyrisht se duhet të ketë sanksione ndaj prokurorëve që mund t'u parashkruhen rastet, posaçërisht këto të korrupsionit", ka thënë Isufaj. Se duhet të ketë përgjegjësi në rastet e parashkruara, pajtohet edhe ushtruesi i detyrës i kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Arben Hoti. "Gjithsesi. Gjyqtarëve të cilëve

iu parashkruhen lëndët duhet të thirren në përgjegjësi. Sidomos parashkrimi relativ është... nuk guxon të ndodhë nëse gjyqtari nuk ndërmerr veprime. Por, shumica e lëndëve që parashkruhen, parashkruhen pasi që gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet për ta siguruar praninë e palëve në procedurë, kanë urdhëresa, ka letërrreshtime ndërkombëtare, por që nuk kemi mundur, apo organet e ndjekjes nuk kanë arritur që ta sigurojnë praninë, se ne punojmë me Policinë e Kosovës", ka thënë Hoti.

Gjykatësit dhe prokurorët për punën e tyre mbahen llogaridhënës qoftë përmes procedurave të disiplinimit apo vlerësimit të performancës. Të dyja këto procese zhvillohen nga mekanizmat brenda Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial. Arrita Rezniciq nga IKD-ja ka vlerësuar se mekanizmat e llogaridhënies dhe vlerësimit të performancës kanë dështuar të mbajnë përgjegjës gjykatësit dhe prokurorët. "Ekziston një solidaritet te mekanizmat e llogaridhënies dhe performancës, që përbëhen nga gjykatës dhe prokurorë, që në shumicën dërrmuese të rasteve i lirojnë nga përgjegjësia gjykatësit dhe prokurorët që e shkelin ligjin", ka thënë Rezniciq. Drejtuesit e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, në të gjitha paraqitjet publike, kanë vlerësuar se duhet të forcohen mekanizmat e llogaridhënies, në mënyrë që të ngrihet llogaridhënia në sistemin e drejtësisë.

Për këtë temë ka folur edhe kreu i Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci. "Prishtina ka probleme të mëdha me numër të madh të lëndëve të pakryera, numri i vogël i gjyqtarëve edhe nganjëherë kur ndodh parashkrimi absolut bëhet një vlerësim se a ka qenë objektivisht gjyqtari në mundësi për ta përfunduar atë

rast apo jo, pasi që te ne nuk ka gjykim në mungesë, do të thotë pa të akuzuarin pa praninë e tij nuk mundesh ta përfundosh lëndën edhe mund të ndodhë të vijë deri te parashkrimi absolut, e tek ai relativ nuk ka arsytim", ka thënë Peci.

Sfida e gjyqtarëve, numri i madh i lëndëve

Ambasada Amerikane në Kosovë përmes projekteve të saj vazhdimisht mbështet sistemin e drejtësisë. Lana Morton-Owens, këshilltare e përhershme ligjore në Departamentin Amerikan të Drejtësisë, ka thënë se gjykatësit janë të sfiduar nga numri i madh i lëndëve në punë. Megjithatë, sipas saj, praktika e gjykatësve amerikanë në menaxhimin e rasteve duhet të zbatohet edhe në Kosovë për t'i shmangur mundësitë e parashkrimit të rasteve. "Është definitivisht një përgjigje e shumanshme. Nuk është një gjë që e shkakton këtë. Mendoj se një pjesë ka të bëjë me çështjen e burimit, një pjesë me çështjen e menaxhimit. Po, ndoshta mund të ketë më shumë gjykatës. Kujtoni se sa raste janë trashëguar gjatë integritetit të veriut, kujtoni se sa raste – vetëm raste të krimeve të luftës – janë trashëguar nga EULEX-i. Pra, Kosova ka marrë një përgjegjësi bukur të madhe kur ka marrë përsipër sistemin e saj të drejtësisë dhe rastet që duhej t'i vazhdonte", ka thënë Morton-Owens.

Përfshirja e zyrtarëve publikë në afëra korruptive, për të cilat raportohet në baza ditore nga organizata të shoqërisë civile dhe mediat, shpesh përfundon pa asnjë pasojë për zyrtarët e dyshuar. Kjo ndodh falë amnitisë legale që këta zyrtarë e përfitojnë nga sistemi i drejtësisë.

Edhe në rastet kur ka aktakuza dhe procedura gjyqësore ndaj zyrtarëve për vepra penale të korrupsionit, në shumë prej këtyre rasteve ndodh që ata të mos gjykohen dhe të amnistohen përjetësisht për ato veprime të pretenduara. Duke vepruar në këtë mënyrë me trajtimin e rasteve të korrupsionit, qytetarët në Kosovë kanë humbur besimin dhe shprehen të pakënaqur me sistemin e drejtësisë ku, sipas raportit të "Pulsit Publik", në tre vjetët e fundit del se kënaqshmëria e qytetarëve me sistemin e drejtësisë sillet prej 15 deri në 25 për qind.

BIK-u s' do ta organizojë pritjen tradicionale të festës së Fitër Bajramit, shkak pandemia

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës (BIK) ka njoftuar opinionin publik se muaji i madhëruar i Ramazanit përfundon nesër (e mërkurë), ndërsa dita e parë e festës së Fitër Bajramit është pasnesër (e enjte). Me këtë rast, BIK-u ka njoftuar se për shkak të situatës pandemike nuk do të ketë manifestim tradicional të festimit të Fitër Bajramit. "Për shkak të gjendjes pandemike në xhamitë e vendit nuk do të ketë manifestim tradicional, madje edhe namazi i sabahut do të falet nëpër shtëpi e nëpër xhamia do të falet vetëm namazi i Fitër Bajramit. Falja e namazit të Fitër Bajramit do të bëhet në orën 05:53, ndërsa xhamitë do të hapen vetëm 15 minuta para faljes së namazit të Bajramit. Kërkohej nga besimtarët që gjatë

faljes së namazit të Fitër Bajramit të mbajnë distancën fizike dhe t'i respektojnë masat kundër Covidit", ka njoftuar BIK-u.

Sipas këtij njoftimi, hytben e Fitër Bajramit në xhaminë e madhe në Prishtinë do ta mbajë myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili do t'i drejtohet opinionit të gjerë me një mesazh të shkurtër për këtë festë. "Po ashtu, për shkak të gjendjes pandemike myftiu i Kosovës nuk do ta organizojë pritjen tradicionale të festës së Fitër Bajramit. Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë ua uron festën e Fitër Bajramit, duke e lutur Zotin që t'i ketë pranuar agjërimin, lutjet dhe ibadetet tona. Me fat festa e Fitër Bajramit!", ka njoftuar BIK-u.



Dy të vdekur dhe 47 raste të reja me Covid në Kosovë



Prishtinë, 10 maj (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 47 raste të reja të infektimit me Covid-19. Sipas raportit të fundit të IKShPK-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar vetëm dy raste të të vdekurve. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në

laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 183 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 47 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 2 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjilan 1 rast (74

vjeç), Rahovec 1 rast (53 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 106 489 raste nga 556 365 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 2 210 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 202 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 97 877 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 402", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve të

reja me Covid sipas secilës komunë. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 19 raste, Mitrovicë 6 raste, Ferizaj 3 raste, Gjilan 3 raste, Podujevë 3 raste, Gjakovë 2 raste, Kaçanik 2 raste, Obiliq 2 raste dhe me nga një rast komunat Drenas, Leposaviq, Pejë, Rahovec, Skenderaj, Suharekë dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka

njoftuar IKShPK-ja. Ndërsa Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se në klinikat për Covid të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe spitaleve të përgjithshme janë duke u trajtuar 410 pacientë. Në raportin 24-orësh të ShSKUK-së është thënë se 27 pacientë janë në gjendje të rënduar shëndetësore dhe 309 janë nën asistim të oksijenoterapisë.

Nesër vijnë në Kosovë edhe 38 mijë e 400 vaksina kundër Covidit

PRISHTINË, 10 MAJ (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka bërë me dije se nesër (e mërkurë) do të pranojë edhe


38 400 doza të tjera të vaksinës kundër Covidit në kuadër të aleancës "COVAX". "Rrjedhimisht deri më tani,

duke llogaritur edhe 24 000 dozat që kemi pranuar javë më parë, në total kemi 62 400 doza. Këto doza do të arrijnë

në Kosovë të mërkurën paradite. Me pranimin e këtyre dozave të vaksinës kundër Covid-19 do të vijohet më tej

vaksinimi i kategorive të parapara sipas planit shtetëror të vaksinimit kundër Covid-19", ka njoftuar MSh-ja.

Qeveria favorizon skemat sociale



PRISHTINË, 10 MAJ - Programi i Qeverisë së Kosovës më shumë ka një komponent sociale sesa zhvillimore. Kështu ka thënë profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu. Ndërsa për kryetarin e Odës së Afarizmit, Skënder Krasniqi, programi që është paraqitur gjatë javës së kaluar nga kryeministri Albin Kurti do të duhej të ishte më i detajuar. Programi i qeverisë, përveç të tjerash, parasheh që asnjë qytetar të mos jetojë në varfëri ekstreme. Për realizimin e tij qeveria ka në plan reformimin e skemave sociale dhe aktivizimin e fuqisë punëtore. Në Raportin e fundit të Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian, vlerësohet se 18 për qind e popullsisë jeton nën vijën e varfërisë, me 45 euro në muaj dhe 5.1 për qind e popullsisë nën vijën e varfërisë ekstreme, me nën 1.90 dollar amerikan në ditë.

Në plan është paraparë edhe një lloj rimbursimi për familjet e varfra, por që nuk jepen detaje se si do të bëhet. Edhe rritja e pagës minimale në 250 nga 130 euro sa është aktualisht dhe ngritjes së pragut të pagës, që nuk tatohet në nivelin e pagës minimale, është në plan të Qeverisë së Kosovës.



Por, me çfarë mjete do të bëhen të gjitha këto?

Profesori i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se me një buxhet prej mbi 2.4 miliardë eurosh sa ka Kosova në këtë vit, është vështirë të realizohen pikat e planit të qeverisë. "Duhet kuptuar që ai buxhet është zotim dhe nuk është para e gatshme. E tëra kjo kërkon angazhim, kërkon përkushtim. Të realizohen të gjitha këto premtime duke pasur parasysh edhe rritjen e pagës minimale, do të jetë një barrë shumë e vështirë. Nëse

mendohet se kjo do të arrihet brenda një viti, është fontanë dëshirash", ka thënë Gërxhaliu. Programit, ka shtuar Gërxhaliu, i mungon ndarja kohore afatshkurtër, afatmesme apo afatgjatë. Megjithatë, sipas tij, asgjë nuk mund të realizohet brenda një viti. "Dua të besoj që me kalimin e kohës do të ketë një prioritizim të këtyre sfidave në aspektin kohor afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë", ka theksuar Gërxhaliu. Ai ka shtuar se për zbatimin e planit, bashkëpunimi publiko-privat dhe dialogu mes opozitës dhe pushtetit duhet të jetë prioritet. Në planin e Qeverisë së

Kosovës është thënë se këto prioritete do të zbatohen brenda kufijve buxhetorë. Prandaj, ekzekutivi planifikon që çdo fillimvit financiar ta rishikojë programin përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.

Kërkohet plan i hollësishëm

Kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka thënë se presin që të kenë një plan më të hollësishëm, një plan i cili, siç thotë Krasniqi, do të tregonte në periudha afatshkurtra synimet e

qeverisë. Nga ajo që është paraqitur deri më tani, Krasniqi ka thënë se plani në aspektin social kërkon shumë mjete buxhetore. "Ne i përshëndesim veprimet për përkrahje sociale, por për të gjitha këto duhet të ketë një buxhet tjetër, jo këtë aktual. Duhet rritje e buxhetit. Për rritje të buxhetit duhet një politikë më e mirë fiskale si dhe infrastrukturë më e mirë ligjore", ka thënë Krasniqi. Pjesë integrale e planit të Qeverisë së Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është edhe diaspora. Sipas këtij plani, përmes krijimit të instrumenteve për investim do të sigurohet që kapitali i diasporës do të kanalizohet në investime që krijojnë vende pune. Prandaj, duke filluar nga ky vit, do të emetohen bono thesari të dedikuara vetëm për mërgatën. Problemet ekonomike dhe sociale Kosovën e kanë përcjellë ndër vite. Rritja ekonomike mesatare në Kosovë prej 4-përqindësh, e cila ishte para pandemisë, nuk ka arritur ta zbusë nivelin e papunësisë, që është rreth 25 për qind. Ky nivel i papunësisë ka bërë që Kosova të jetë shteti më i varfër në rajon, duke luftuar me nivele të larta të varfërisë.

Gastronomët paralajmërojnë protesta të "ashpra" nëse nuk zgjatet orari i punës

PRISHTINË, 10 MAJ - Kryetari i Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, Petrit Klllokoqi, ka paralajmëruar protesta, siç ka thënë ai, të ashpra nëse nuk zgjatet orari i punës për sektorin e gastronomisë. Ai ka thënë se nuk do t'i nënshtrohen asnjë qeverie në raport me kërkesat e gastronomëve. Në këtë kontekst, Klllokoqi ka thënë se nuk do të përkrahin asnjë vendim që merret ad hoc për sektorin e gastronomisë. "Ne nuk do t'i nënshtrohemi asnjë qeverie. Një gjë është e qartë që të gjithë gastronomët kanë bindje të ndryshme politike, mirëpo e kanë interesin e njëjtë, dhe kur preket interesi ynë atëherë ne duhet t'i provojmë të gjitha rrugët demokratike të cilat na takojnë. Kuptohet, nuk i shmangemi edhe protestës edhe daljes në rrugë. Po shpresojmë të arrijmë në bisedime, mirëpo nëse nuk do të gjejmë një rrugë të përbashkët, s'na mbetet tjetër vetëm protesta. Ne jemi duke

biseduar për hapjen e klubeve të natës dhe sallave të dasmave. Kuptohet që këto nuk mund të mbahen ditën dhe orari i punës duhet të zgjatet dhe të hiqet ora policore totalisht", është ka thënë Klllokoqi për "EO". Më tutje, ai ka bërë me dije se qeveria ende nuk ua ka paguar subvencionimin e pagës dhe qirasë. "Kur ke mbyllja 12 ditore nga qeveria na është premtuar që do të na subvencionohen pagat dhe qiraja në fund të muajit prill dhe në fillim të muajit maj. Tash jemi më 10 maj dhe nuk ka asnjë koment prej qeverisë. Kuptohet se kjo është ndër pakënaqësitë tona. Kemi pasur takime të njëpasnjëshme me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, ku u pajtuam për masat e reja që, nëse i respektojmë ne dhe ka ulje të numrave, atëherë duhet të bisedojmë për rritjen e orarit ose do të shkojmë duke u lehtësuar masat. Kjo nuk ndodhi dhe në formë arbitrare ata morën vendim pa diskutim



me ne", është shprehur Klllokoqi, duke shtuar se në bazë të të dhënave të tyre, janë rreth 10 mijë vende të punës që janë

"shuar" për shkak të pandemisë. "Ne gjithmonë jemi hallexhi, i takojmë botës së biznesit. Ne nuk jemi për protesta, por nëse

marrin vendime arbitrare, pa konsultë me neve, kuptohet që do të dalim në protesta", ka thënë Klllokoqi.

Kosova dhe Izraeli merren vesh për thellimin e bashkëpunimit ekonomik



PRISHTINË, 10 MAJ - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka njoftuar se drejtori ekzekutiv i këtij asociacioni, Sazan Ibrahim, ka diskutuar me përfaqësuesin e Korporatës për Zhvillim dhe Investim të Izraelit në Kosovë (KIDIC) lidhur me mundësitë e

bashkëpunimit ekonomik për segmentet e caktuara të qeverisjes lokale. Po në takim është bërë me dije se është biseduar për shkëmbimin e përvojave rreth menaxhimit të situatës me pandeminë Covid-19. "Gjatë diskutimeve u pa mundësia e investimeve

përmes KIDIC-it në komunat e Republikës së Kosovës në agroteknologji, ku me këtë rast do të krijoheshin shumë vende të punës në Kosovë. Në këtë drejtim z. Sazan Ibrahim njoftoi z. Brikman rreth mundësive të komunave për dhënien e pronës komunale në

shfrytëzim dhe gatishmërisë së AKK-së për bashkëpunim në këtë drejtim. Po në këtë takim u bisedua për shkëmbimin e përvojave rreth menaxhimit të situatës me pandeminë Covid-19. Në anën tjetër, drejtori i AKK-së e informoi përfaqësuesin e KIDIC-it rreth

rolit të komunave për menaxhimin e situatës dhe angazhimit të kryetarëve në veçanti dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me KIDIC-in sa i përket shkëmbimit të përvojave rreth situatës me Covid-19", është thënë në njoftimin e AKK-së.

Televizioni publik gjerman shkruan për mbylljen e gazetave në Kosovë

BERLIN, 10 MAJ - Televizioni publik gjerman ARD, në edicionin "Weltspiegel" (Pasqyra e botës), ka shkruar për mbylljen e gazetave ditore në Kosovë. Në një shkrim të shkurtër për katër gazetat që botoheshin deri para pandemisë, një vit më parë, televizioni ARD ka shprehur shqetësim që në Kosovë nuk botohet asnjë gazetë fizike.

ARD e nis shkrimin për mbylljen e gazetave me pronarin e një kioske në qendër të Prishtinës, Shaip Murturi, i cili për këtë televizion tregon me dorë vendin në raftet që dikur rezervoheshin për gazetë ditore. Meqë sot gazetat e shtypura të Kosovës mungojnë, ai i mbushi raftet me ëmbëlsira. Pronari i kioskës, Shaip Murturi, dikur punonte në rrjetin e

shitjes për ndërmarrjen "Rilindja", e cila në kohët më të mira kishte një qarkullim prej 200 000 kopjesh të gazetës. "Një shoqëri që nuk është në gjendje të shtypë të paktën një gazetë ditore është duke shkuar në drejtim të gabuar", thotë ai.

Në mars të vitit 2020 Qeveria e Kosovës nxori një numër rregullash kufizimi karantine, përfshirë ndalimin e shtypjes dhe të shpërndarjes së gazetave ditore. Botuesit e gazetave ndaluan shtypjen e tyre menjëherë, me shpresë se do të ndihmoheshin nga qeveria pas heqjes së masave kufizuese. Por, edhe pse u hoqën masat e shtypjes dhe të shpërndarjes së gazetave, ndihma e qeverisë nuk iu dha mediave të shtypura. Pas pavarësisë, në vitin 2008, në Kosovë botoheshin tetë gazeta



ditore. Një vjet më parë (2020) mbetën vetëm katër: "Koha ditore", "Epoka e re", "Bota sot" dhe "Zëri". Nuk është e qartë

nëse dhe kur do të botohen prapë gazetat e përditshme në Kosovë. Qeveria nuk po ofron ndihmë financiare për to,

ndërsa botuesit e gazetave thonë se nuk mund të përballojnë më koston e lartë të shtypit.

Haziri: Gjilani po kalon ditë të zeza, solidarizohemi me familjen Haliti që humbi tre anëtarë

GJILAN, 10 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se gjilanasit janë duke kaluar ditë të zeza pas tragjedisë së familjes Haliti, e cila ka humbur tre anëtarë në Shqipëri, të cilët dyshohet se janë helmuar. Këto komente Haziri i ka bërë në konferencën për media, duke shtuar se më 7 maj ishte njoftuar për gjendjen e rënduar të kësaj familje. "Unë jam njoftuar për gjendjen e rënduar të kësaj familjeje më 7 maj. Menjëherë kemi shprehur interesimin dhe komunikimin drejtpërdrejt edhe përmes Ambasadës së Republikës së Shqipërisë. Fatkeqësisht, ka qenë gjithçka e vonshme dhe këta tre anëtarë të familjes Haliti u shuan. Gjilani po kalon ditë të zeza, duke u solidarizuar me familjen Haliti për këtë humbje të madhe e cila, po ashtu, duhet ta përballojë këtë gjendje pasi tre djem dhe një vajzë të moshës madhore janë trashëgimi e kësaj familje", ka thënë Haziri,



duke shtuar se janë duke pritur rezultatin zyrtar të hetimeve të institucioneve të shtetit shqiptar në mënyrë që edhe familja dhe komuniteti të jenë më të qetë.

"Më 8 maj zyrtarisht jam njoftuar nga institucionet e Shqipërisë për ndërmarrjen e

veprimeve urgjente të organeve të shtetit, që përfshijnë krimet e rënda për fillimin e hetimeve dhe ndërmarrjet e para hetimore. Presim rezultatin zyrtar në mënyrë që edhe familja dhe komuniteti të jenë më të qetë", është shprehur Haziri.

Lladrovci përkujton betejën e Llapushnikut: Vendbetejë e qëndresës dhe heroizmit të rrallë

DRENAS, 10 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka përkujtuar betejën e Grykës së Llapushnikut si vendbetejë e qëndresës së lavdishme dhe heroizmit të rrallë, gjë që e bën atë të paharruar. Kryetari Lladrovci ka theksuar se UÇK-ja në Llapushnik ka konfirmuar se djemtë e vajzat e kombit e duan lirinë e Kosovës më shumë se jetën e vet. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në Ditën e Evropës, ia

konfirmonte asaj në Llapushnik se djemtë e vajzat më të mira të kombit e duan lirinë e Kosovës më shumë se jetën e vet. Beteja e Grykës së Llapushnikut nga UÇK-ja hyri në agjendën çlirimtare si vendbetejë e qëndresës së lavdishme dhe heroizmit të rrallë, andaj mbetet përgjithmonë e paharrueshme. Lavdi heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të lirisë! Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!", ka thënë Lladrovci.



Aliu thotë se Ferizaj po bëhet model për komunat e tjera

Ferizaj, 10 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se është në përfundim rregullimi i nënkallimit afër "Plus Marketit". Me këtë rast, Aliu ka thënë se Ferizaj është duke u transformuar në qendër urbane, i cili, sipas tij, është

duke u shndërruar si model për komunat e tjera. "Me guxim e dije, pasion për të mirën për qytetarët, asgjë nuk e ndal ndryshimin e madh të Ferizajt. Asfaltimi i nënkallimit afër 'Plus Marketit' bën pothuajse gati një vepër infrastrukturore të munguar për dekada që i jep

funksionalitet qarkullimit rrugor në qendër dhe mundësi të shumëfishuar zhvillimi, bizneseve të kësaj ane. Ferizaj po bëhet qendër urbane me infrastrukturë rrugore, model në gjithë vendin", ka shkruar Aliu në llogarinë e vet në "Facebook".



Strategjia e shërbimit sekret serb për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pas vitit 2000 e këndej (1)



Faton B. MEHMETAJ

Që nga viti 1999 kur forcat serbe u tërhoqën nga Kosova, një pjesë elitare e këtyre forcave mbeti në Kosovë e ngarkuar me detyra të veçanta, e disa prej tyre edhe me detyra strategjike. Këto struktura kanë pasur një koordinim të fuqishëm me shërbimin informativ në Beograd, qofshin ato ushtarake, politike apo diplomatike. Tashmë pas 20 viteve janë bërë të ditura publike gati për secilin, se kjo strukturë ka qenë në koordinim të plotë me administratën e UNMIK-ut dhe pasuesve të tyre të më vonshëm EULEX-in. Të gjitha bashkë hartuan planin për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së, duke planifikuar edhe kohën optimale për ta arritur këtë qëllim. Për shumë vite rresht, shërbimet sekrete serbe në koordinim dhe bashkëveprim me njësitë e tyre që i kishin lënë në Kosovë, i përdorën protestat dhe trazirat në Mitrovicën e veriut por edhe në enklava tjera me popullatë serbe për ta goditur imunitetin shtetëror të Kosovës që ishte në fazën e shtetndërtimit. Madje trazirat e organizuara nga organizatat militare serbe, u përdorën edhe për ta stërvitur pakicën serbe për ta mbisunduar shumicën shqiptare. Serbia qe 20 vite rresht i mban në Kosovë strukturat paralele të aktivizuara për ta luftuar pavarësinë e Kosovës. Këto struktura gjatë kësaj kohe, bënë trazira, i sulmuan KFOR-in, UNMIK-un, EULEX-in e kush u doli përpara, vranë e plaçkitën pa i dhënë llogari askujt. Për këto shtresa ligji ishte në duart e tyre. Në anën tjetër për shumë kohë një pjesë e policisë serbe të ShPK-së dhe më vonë PK-së, veçanërisht në veriun e Mitrovicës, kanë marrë paga të dyfishta, nga buxheti i Kosovës dhe nga MUP-i i Serbisë. Shkatërrimi dhe djegia e pikave kufitare 1 në Jarinjë dhe 31 në Bernjakë në veri të Kosovës në kufirin me Serbinë nga strukturat paramilitare serbe ishin sinjal i qartë se në krahun e këtyre strukturave janë edhe administrata e UNMIK-ut dhe të tjerët. Ata plagosen dhjetëra ushtar te KFOR-it dhe vranë prestarin e forcave speciale të Kosovës, Enver Zymberin.

Strukturat paramilitare serbe që vepronin në Kosovë i kërcënuan publikisht, madje edhe para KFOR-it, EULEX-it etj, qytetarët serb që e pranonin shtetësinë e Kosovës. Ata i rrahën, ua dogjën shtëpitë, veturat e disa prej tyre i vranë. Strukturat paramilitare serbe që vepronin në Kosovë e vranë zyrtarin e EULEX-it, lituanezi Audrius Shenavicius në shtator të vitit 2013, ato struktura për qëllime politike organizuan edhe vrasjen e politikanit të partisë liberale serbe në Komunën e veriut të Mitrovicës, Dimitrije Janičijević në janar të vitit 2014. Vrasja e Janičijevićit ishte një paralajmërim që tregonte se cili është fati që i pret të gjithë serbët që e pranojnë shtetin Kosovë. Këto vrasje sikurse edhe vrasja e politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanović në vitin 2018 në veri të Mitrovicës janë të motivuara politikisht, por se nuk janë zbardhur e zbuluar sepse kryesit e këtyre veprave nuk janë shqiptarët. Udhëheqësit e strukturave paralele, pos që organizuan një varg vrasjesh të motivuara politikisht (vrasje të kundërshtarëve të tyre politik), kundërshtuan më dhunë UNMIK-un dhe KFOR-in. Në këto kundërshtime ata plagosën me dhjetëra ushtar të KFOR-it e të paqeruajtësve tjerë. Që atëherë e deri më sot për këto vepra nuk është përgjigjur askush. Po të ishin pjesëtarët e UÇK-së, të dyshuar apo kryes të këtyre veprave sigurisht se do të ishin arrestuar qindra vetë dhe do të ishin organizuar me dhjetëra e dhjetëra gjyqe. Strukturat paralele serbe të mbështetur edhe nga forcat paramilitare të Serbisë, para syve të BE-së e botës së qytetëruar, arritën që në Kosovë ta krijojnë një territor të pasigurt. Ata e kontrabandojnë gjysmën e kapitalit të Kosovës dhe janë në rregull me BE-në, me KFOR-in, EULEX-in e strukturat e drejtësisë. E vetmja gjë që u shikua më llupen e të gjithëve ishte puna dhe aktiviteti i strukturave të UÇK-së. Për realizimin e këtij projekti shërbimet sekrete serbe përdorën klasën naive e të papërgjegjshme politike të Kosovës, kolonën e pestë, bashkëpunëtorët e tyre, ekspertet ushtarak, zinxhirin e bashkëpunëtorëve dhe financat. Krahas angazhimit të serbëve vendorë që kanë mbetur në Kosovë, shërbimet serbe qe nga viti 2004 e këndej e kanë konsoliduar rrjetin e tyre shqipfolës, dhe këtë në bazë të shantazheve për të mos zbuluar veprimtaritë e tyre të mëparshme. Askush në Kosovë

nuk i denoncon shërbimet sekrete serbe dhe veprimtarinë e tyre që janë duke e bërë kundër UÇK-së dhe klasës së mirëfilltë politike që është vënë në shërbim të mirëfilltë të ndërtimit të shtetit të Kosovës. Organet tona të sigurisë duke përfshirë këtu edhe AKI-në duhet të bëjnë çmos për ta penguar me të gjitha mjetet rrjetin e bashkëpunëtorëve të shërbimit serb shqipfolës të mos jenë partner në punën e përbashkët me shërbimet serbe për ta dëmtuar shtetin e Kosovës. Sepse deri më sot dëmet janë të pariparueshme. Strukturat në fjalë arritën ta përçajnë klasën tonë politike, ta komprometojnë ta etiketojnë, madje disa departamente me ndikim në shtet arritën t'i demunizojnë, por edhe t'i komprometojnë si institucione. Fatkeqësisht shërbimet sekrete serbe përmes projekteve të shërbimit arriti t'i fus agentet e vet në strukturat ndërkombëtare në Kosovë, qofshin ata shqipfolës, serb, maqedonas, malazez a të tjerë. Ata përmes këtij rrjeti filluan të ngjallin mosbesim tek faktori shqiptar. UNMIK-u krijoj dhe financoj një gazetari përmes së cilës lansonte dezinformata dhe linçonte kë donte duke i ngritur akuzat publike, dhe njollosur me akuzat nga më të ndryshmet. Prapa këtij projekti qëndronin ekipe të tëra ekspertesh, të fushave mediatike të sigurisë por edhe të shërbimeve të cilët e përpunuan një pjesë të opinionit duke e shndërruar atë në mekanizëm të vetin për t'i lansuar e përhapur dezinformatat e tyre. Si pasojë e këtij projekti, gazetarët dhe mediet u ndanë në dy grupe, njëri grup tentonte me ç'do kusht t'i vente pluhur se vërtetës e tjetri kërkonte të vërtetën. Kështu ishte edhe më herët kur në Kosovë mbretëronte një anarki e kaos. Dua të cek se vetëm gjatë vitit 1989-1990 ishin paraqitur 98 raste të reime dhunimesh e tentim dhunimesh të serbeve nga

shqiptarët. Gjatë këtij viti shqiptarët u akuzuan edhe për disa vrasje dhe tentim vrasje që i kishin bërë serbet dhe i akuzuan shqiptarët. Të gjitha këto akuzat prapa të cilave qëndronin shërbimet sekrete serbe dhe bashkëpunëtorët e tyre te fushës mediatike dolën të pavërteta. U gjetën kryesit e vërtetë të këtyre veprave që ishin serbët, por vuajtët dhe njollosjet nuk u hoqën kurrë. Sa për ilustrim po përmendi vrasjen e gjashtë të rinjve serb në Pejë, në kafenenë "Panda" që ndodhi në dhjetor të vitit 1998, siç dihet dhe është marrë vesh në këtë masakër kishte marrë pjesë policia sekrete serbe në bashkëpunim me institucionet e shtetit serb. Kjo vrasje u bë me pretekst, që t'ia veshur UÇK-së dhe ta akuzojnë kinse ka vranë fëmijë serb të pafajshëm. Nebojsa Zhivković ishte hetuesi i kësaj ngjarje. Shqiptarët që u akuzuan për këtë akt u dënuan për veprimtari armiqësore, e jo për terrorizëm apo kryerjen e kësaj masakre. Të dënuarët shqiptar rreth këtij rasti u liruan në dhjetor të vitit 1999 me ndërmjetësimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Madje për rastin "Panda" shërbimi sekret serb u përpoq t'i akuzonte agentet e Shërbimit sekret britanik MI6 dhe SAS, por ky proces u ndërpre me ndërhyrjen e Aleksandër Vuçiqit, i cili i paralajmëroj drejtuesit e shërbimit sekret serbe me akuzat të tilla mund të shpërthejnë skandale të mëdha ndërkombëtare. Për ta mbuluar këtë rast sa më mirë, shërbimi sekret serb kishte hartuar një vendim të fshehtë për ta mbuluar masakrën në kafenenë "Panda" dhe për t'i mbikëqyr pjesëtarët e JSO-s që të mos e zbulojnë të vërtetën rreth rastit "Panda", duke thënë se ndëshkimi bie mbi secilin që guxon të flas për këtë ngjarje qoftë ai kryetari apo kryeministri. Gjykatësi i rastit "Panda", por edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të

Brendshme të Serbisë (MUP) e dinin se rasti nuk guxon të zbardhet as të zbulohet. Më vonë këtë rast nënë trysninë e faktorit ndërkombëtar e zbuluan zyrtarët e shërbimeve sekrete serbe dhe treguan se vrasjen e fëmijëve në kafenenë "Panda" në Pejë e kanë kryer njësitë e JSO-s të cilën e drejtonte Millorad Ulemek - Legia i urdhëruar nga Radomir Marković, ish-shef i SDB-së më qëllim që këtë vrasje t'ia atribuon UÇK-së për ta komprometuar në arenën ndërkombëtare. Në këto kohëra për një periudhë 10-vjeçare u morën, u maltretuan dhe kaluan nëpër duart e policisë serbe mbi 500 mijë shqiptar krejtësisht të pafajshëm. Nga viti 1989-1990, Aradha e Bashkuar e Policisë së SPB-së i kishte vranë mbi 60 protestues shqiptarë që kishin marrë pjesë në protesta për të drejtat e tyre kushtetuese. Pos këtyre Beogradi akuzoi politikanët e vendosur shqiptarë, policinë e Kosovës për iniciimin dhe përkrahjen e shqiptarëve nacionalistë të cilët po punojnë për ta pavarësuar Kosovën nga Serbia. Fatkeqësisht në këto periudha 1990-1998 kishte mjaft shqiptar që punonin për Millosheviqin dhe qeverinë e tij. I përmenda disa shembuj nga e kaluara e afërt për të treguar se pothuajse të njëjtat gjëra po përsëriten sot, nga të njëjtit njerëz por tash te kamuflluar në struktura të ndryshme politike, në rrjetin e UNMIK-ut, si biznesmen, dhe nomenklaturave tjera ku Serbia ka ndikim, ajo, arriti që përmes këtyre formave dhe projekteve ta ruaj ndikimin serb në Kosovë. Për një kohë të shkurtër shërbimet sekrete serbe të koordinuara edhe me njësitë e tyre që i kishin lënë në Kosovë, filluan ta marrin kontrollin e plotë tek nëntoka e Kosovës, bota e krimin e veprimtari tjera të krimin të organizuar politik dhe ekonomik që edhe sot e gjithmonë është kontrolluar nga shërbimet sekrete serb. (Vijon)



Qeveria Kurti 2, ditët e numëruara!



Shkruan: Hisen BERISHA

Siç duket, z. Kurti nuk nxori mësimet e duhura gjatë qeverisjes Kurti 1 kur provojë të përplasej me administratën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pretendimi se ne mund të mbijetojmë me forcat tona, (edukatë kjo e trashëguar nga

diktatura komuniste, në tagmën se “edhe barë do hamë”), është vetëvrasje për Kosovën dhe popullin e saj. Se ndryshimet në administratën amerikane sjellin ndryshime edhe në objektivat strategjike nacionale të politikës së jashtme të Amerikës, është tregues i mosnjohjes si funksionon ShBA-ja dhe injoranca ideologjike që të mbajë në harkun e mbyllur të mjerimit filozofik.

Se ShBA-ja është konsistente në politiken e tyre të jashtme tregoi edhe qëndrimi i z. Blinken dhe meqë nuk i mjaftoi ekipit qeverisës Kurti 2, tani u bë e qartë edhe nga vetë

presidenti Biden: “Marrëveshja e Uashingtonit është baza mbi të cilën mund të ndërtohet rruga përpara për Kosovën dhe Serbinë në rajon”.

Këtu nuk ndihmon as dogma kurtiane se “Kosova nuk është Meksikë e ta ketë Amerikën pranë, ndaj ne na duhen Lajçaku e Borrelli për të ecë përpara” dhe as revansi naiv ndaj personaliteteve që humbin zgjedhjet në ShBA, siç ndodhi me administratën Trump dhe të ngarkuarin e tij për Kosovën, z. Grenell, shefin e të gjitha shërbimeve inteligjente të Amerikës, ngase atje vlen parimi ushtarak “një herë marins, tërë jetën marins”

pra asnjëherë nuk pushon përkushtimi i tyre në politikën e shtetit.

Nuk ndihmon as servilizmi panevropian duke mohuar me dogmatizëm ballkanik, zotimet që u morën në Uashington me formulime se “ne nuk mendonim të zbatojmë atë marrëveshje” duke aluduar në Marrëveshjen e zotimeve në Uashington, arritja e së cilës ishte precedent protokollar në administratën dhe diplomacinë amerikane, përjashtimi që u bë për Kosovën.

Kjo situatë e krijuar nga reagimi i presidentit Biden është vërejtja e fundit se

Qeveria Kurti 2, po nuk bëri kthesë në raport me ShBA-në dhe rolin e saj imediat dhe permanent për Kosovën e të ardhmen e saj, i ka ditët e numëruar. Nëse në rastin e parë qeverisja Kurti 1 mbijetoi 52 ditë, tani mund ta ketë afatin më të shkurtër, apo edhe nëse zgjat, do ta ketë fundin fatal.

Një duhet ta dinë të gjithë, se ai që pretendon ta shkëpusë miqësinë permanente strategjike të Kosovës me ShBA-në, amanet i presidentit të lavdishëm dr. Ibrahim Rugova dhe politikat integruese euro dhe atlantike, duhet trajtuar si Esat Pashë Toptani.

Një ditë Maroku kërkoi t'i bashkohej Evropës



Shkruan: Valmir ELEZI

Vitet '80 të shekullit të kaluar ishin përgjithësisht të qeta për Evropën, pa kujtuar këtu përmblylljen madhështore të asaj dekade me grisjen e 'perdes së hekurt' që kishte ndarë jo vetëm kontinentin e vjetër, por edhe botën në përgjithësi.

Ato vite janë kohë e rinisjes së procesit të integritimit evropian. Më 1 janar 1986 dy shtete u anëtarësuan në komunitet, duke arritur në 12 numrin e shteteve anëtare. Zgjerimi i BE-së po ndodhte në rrethana të një optimizmi për mposhtjen e komunizmit dhe ngadhënjimin e demokracisë.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian kishte filluar të sillte shpresë për shumë vende.

Pikërisht një ditë, të vitit 1987, Maroku paraqiti kërkesën surprizuese për t'iu bashkuar Evropës.

Maroku konsiderohej deri në atë kohë si shteti joanëtar më i lidhur me komunitetin evropian. Ai ndodhet në Afrikën veriperëndimore dhe vetëm pak kilometra të mbushura me ujë e ndajnë nga Spanja që një vit më herët ishte bërë anëtare e komunitetit. Megjithatë, kërkesa e këtij shteti afrikan u refuzua sepse nuk konsiderohej si 'vend evropian' dhe, si i tillë, nuk mund të bashkohej. Me pak fjalë, Maroku nuk plotësonte kriterin gjeografik.

Ndryshimet e asaj kohe me rënien e Murit të Berlinit bënë që interesimi më i madh i Evropës të përqendrohej në një drejtim

tjetër dhe rajoni i Mesdheut nuk kishte edhe aq shumë vëmendje. Në ditët tona, Ballkani Perëndimor, i ndodhur gjeografikisht në kontinentin evropian, kërkon pikërisht vëmendjen konkrete dhe jo shprehjet e zakonshme se rajoni ynë 'ka të ardhme të sigurt evropiane'. Një zë i qartë evropian shpeshherë mungon dhe kjo ka krijuar terren për shtete që duan të zhbëjnë të arriturat e botës perëndimore.

Jo vetëm i ndodhur gjeografikisht, por e veçanta është se gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor janë të rrethuara me shtete që tashmë prej vitesh janë bërë pjesë e BE-së.

Prej një dekade Bashkimi Evropian ka marrë rolin nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të lehtësuar dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të arritur një marrëveshje përfundimtare, e cila do t'i shërbente paqes në këtë pjesë të kontinentit evropian, si synim përfundimtar. Kjo është një ndërmarrje e madhe e BE-së, e cila që nga fillimi ka pasur mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për të arritur paqen në këtë rajon që ka qenë prej dekadash pikë e nxehtë e rivalitetit mes superfuqive.

Ajo çfarë mund të dëshmojë Bashkimi Evropian në dialogun Kosovë - Serbi mund të shërbejë për më shumë shpresë në këtë rajon evropian, apo të provokojë të kundërtën. Deri më sot, fjala vjen, asnjëherë zyrtarët evropian nuk e kanë përmendur integritimin e përshtetshëm në BE si një model që do të ndihmonte në arritjen e paqes së qëndrueshme në Ballkan. Emisari evropian në këtë dialog, Miroslav Lajçak nuk ishte shumë shpjegues kur zbuloi për herë të parë se për

Kosovën “suksesi në dialog do të thotë të bëhet vend kandidat”. Ai nuk ka treguar publikisht për koston e këtij suksesi si dhe nëse kjo është e ndërlidhur domosdoshmërisht me idenë e shprehur po nga ai se Kosova duhet të ndryshojë Kushtetutën, duke krijuar hapësirë për Asociacionin, një temë që prej kohësh ka polarizuar ashpër spektrin politik dhe vështirë e kapërcyeshme. Ndonëse mozaiku i deklaratave të tij duket se ende është i paplotë, ndërmjetësuesi evropian është i pozicionuar qartë.

Në rrethana të tilla anshmërie, mund të krijohen probleme të mëdha, sepse kjo nuk është një marrëveshje vetëm mes dy

vendeve, Kosovës dhe Serbisë. Normalizimi i marrëdhënieve mes tyre, është normalizim i marrëdhënieve në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Bashkimi Evropian duhet t'i flasë këtij rajoni në mënyrë të qartë për perspektivën e integritimit evropian. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme për shkak të prezencës së shtuar ruse pikërisht në këtë hapësirë dhe ndikimin në rritje për të penguar zgjerimin politik, por edhe të aleancave ushtarake. Për këtë situatë ka ndikuar edhe vetë Bashkimi Evropian duke mos qenë i bashkuar në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë pikërisht me integritimin e rajonit. Nganjëherë edhe përçarjet brenda vetë BE-së


kanë krijuar hapësirë për ndikimin rus.

Evropa duhet të mos dëgjojë zërat se një zgjerim i mëtejshëm do të dobësonte edhe më shumë Bashkimin Evropian. Ligjërimi i optimistëve dhe ithtarëve të BE-së për zgjerimin si dobi e përgjithshme dhe që e bën Evropën më të fuqishme, nuk duhet braktisur.

Qartësia dhe vendosmëria është e domosdoshme për t'i dhënë fund kësaj prezence, e cila në thelb përfiton duke mbajtur rajonin në një tension të vazhdueshëm.

***Autori ka mbaruar studimet Master për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës.**





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartën në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ylli synon titull, Peja nuk dorëzohet



PRISHTINË, 10 MAJ - Sonte (e martë) do të zhvillohet përballja e tretë e finaleve të "play-off"-it në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll ndërmjet Pejës dhe Golden Eagle Yllit. "Nuk po them që ka përfunduar, por rezultati 2-0 është rezultat i mirë. Nëse gjuajmë më shumë, do të shënojmë më shumë pikë, por në finale ndodhin këto gjëra dhe jemi të lodhur paksa nga ritmi dhe dinamika e madhe, por jemi të kënaqur. Dua ta shfrytëzoj rastin t'i dëshiroj shërim sa më të shpejtë lojtarit Dendy, por edhe Leo Mekaj. Tani do të rikthehet edhe AJ Walton dhe ata do të jenë më të rrezikshëm me treshe, por ne do të përgatitemi, për festë nuk kemi

kohë dhe shkojmë në Pejë për fitore", ka thënë basketbollisti i Yllit, Erion Kastrati.

Skuadra nga Theranda ka fituar dy ndeshjet e para dhe i mungon edhe një fitore për t'u shpallur kampion, që do të ishte i pari në histori të klubit. Ndërkohë, pejanët hynë për fitore për ta ngushtuar serinë në 1:2, ku do të rikthehet edhe AJ Walton, i cili ishte i suspenduar. Ndeshjen e parë e fitoi Ylli në Pejë 75:83, kurse sfidën e dytë e fitoi në shtëpi 75:73, me një fund dramatik. Për Yllin do të ishte titulli i parë në histori, derisa pejanët kërkojnë titullin e gjashtë. Skuadra nga Theranda këtë edicion fitoi Ligën Unike, duke mundur

në finale pikërisht Pejën dhe po e kërkon trofeun e dytë në këtë edicion. Peja në çerekfinale kishte mundur Sigal Prishtinën 2:1, derisa në gjysmëfinale u përballë me Ponte Prizrenin, ku kaloi në finale me serinë 3:2, pasi takimi i fundit ishte ndërprerë pas pjesës së parë dhe u takoi pejanëve me rezultat zyrtar 20:0. Golden Eagle Ylli në çerekfinale eliminoi Bashkimin 2:1, edhe pse humbi sfidën e parë, ndërsa në gjysmëfinale pas pesë sfidave shumë interesante eliminoi Rahovecin 3:2. Ndeshja Peja - Golden Eagle Ylli zhvillohet të martën nga ora 20:15 në 'Karagaqi' dhe transmetohet në "ArtMotion" dhe "Kujtesa".

SHKURT

Chelsea shpërblen Brojën me kontratë të re

Armando Broja është duke kaluar në një formë të mirë në Eredivisie me skuadrën e Vitesse. Shqiptari ka shënuar tashmë 11 gola në fanellën e Vitesse dhe, si duket, ka bindur drejtuesit e Chelsea me paraqitjet e tij fantastike. 19-vjeçari është transferuar në Vitesse në formë huazimi dhe ka shkëlqyer në sezonin 2020/2021, tani Chelsea planifikon ta shpërblejë sulmuesin shqiptar me një kontratë të re. Sipas korrespondentit të Chelsea të kuadër të "Goal.com", Nizaar Kinsella, Chelsea ka bërë me dije dëshirën e tyre për të rinovuar me Brojën.

Kane mund t'i bashkohet Barçës

E ardhmja e sulmuesit Harry Kane lidhet me skuadrën e Barcelonës. Mediat në ishull raportojnë se sulmuesi anglez është i interesuar të largohet nga Tottenham Hotspur derisa Barça shihet si një skuadër ideale për të fituar trofe. Interesim për kapitenin e "Spurs"-ave ka shfaqur edhe Manchester Unitedi.

Krasniqi ftohet nga Malajzia

Futbollisti nga Kosova, Liridon Krasniqi, do ta përfaqësojë shtetin aziatik në kualifikimet e Botërorit 2022. Ish-përfaqësuesi i Kosovës ftohet për herë të parë te Malajzia derisa paraprakisht kishte luajtur për "dardanët". Selektori Tan Cheng Hoe e ka zbuluar listën e 25 futbollistëve të cilët do të jenë pjesë e ekipit për tri ndeshjet e mbetura të raundit të dytë kualifikues për Botërorin 2022, regjioni i Azisë. Në mesin e tyre shihet edhe emri i Krasniqit. Aktualisht futbollisti shtatlartë është pjesë e ekipit Newcastle Jets në kampionatin australian. Malajzia do të përballet me Emiratet e Bashkuara Arabe më 3 qershor, me Vietnamin më 11 dhe me Tajlandën më 15 qershor.

Të mërkurën finalja e Kupës, Dukagjini - Llapi

PRISHTINË, 10 MAJ - Dukagjini nga Liga e Parë dhe Llapi nga Superliga do të përballen në kuadër të finaleve të Kupës së Kosovës në futboll. Dukagjini ka arritur në finale duke

mpostur në çerekfinale skuadrën e Superligës, Drenicën. Në gjysmëfinale skuadra e Armend Dallkut mposhti Istogun, ndërsa Llapi në çerekfinale

eliminoi Trepçën '89 dhe në gjysmëfinale arriti ta eliminojë Prishtinën. Ndeshja zhvillohet më 12 maj 2021 në orën 20:45, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.



Hamiltoni: Jam në formë, fitova falë një strategjie më të mirë

BARCELONË, 10 MAJ - Pista e Barcelonës është konfirmuar edhe një herë e mbarë për Mercedesin dhe Lewis Hamilton, që në Spanjë korri suksesin e pestë radhazi. Piloti britanik shfrytëzoi më së miri dy "pit-stop" për të parakaluar në xhirot e fundit

rivalin e tij kryesor për titull, Max Verstappen me Red Bullin. "Puna e madhe dhe e lodhshme e gjithë skuadrës po jep frytet e saj. Nisja e garës ishte e vështirë, pasi kishte shumë papastërti në pistë dhe Red Bulli u nis mjaft mirë. Gjithsesi,

strategjia që ndoqëm me gomat ishte ajo e duhura dhe pas ndalesës së dytë rikuperuam ndaj Max", ka thënë Hamilton. "Nuk ishte kjo strategjia që kishim planifikuar, por e dinim që do të bënim dy ndalesa. Problem ishte se kur do ta

bëja ndalesën e dytë, pasi përvoja më thoshte se me një ndalesë nuk do t'ia dilja mbanë. Gjithsesi, e rëndësishme ishte fitorja dhe fakti që publiku u argëtua. Jam në formë dhe rezultatet e tregojnë", ka shtuar Hamiltoni.



"Zgjohen" Lakersat

LOS ANGELES, 10 MAJ - Los Angeles Lakers rikthen te fitorja pas dy humbjeve radhazi ndaj Blazersit dhe Clippersit. Kalifornianët triumfuan 123-110 ndaj Phoenix Sunsit, edhe pse vazhdon të mungojë LeBron Jamesi. Skuadra e drejtuar nga Frank Vogel u udhëhoq në suksesin ndaj ekipit nga Arizona nga një Anthony Davies monstroz, autor i 42 pikëve dhe 12 "rebounde". Ndërkohë që për Sunsin më i miri mbi parket rezultoi Cameron Payne, i ardhur nga bankina, me 24 pikë. Në Lindje, Mimi Heat triumfoi në përballjen direkte ndaj Boston Celticsit për zonën "play-off" me rezultatit 124-130. Në "TD Garden" shkëlqeu Jimmy Butler, që për pak e mbylli ndeshjen me "triple double", duke shënuar 26 pikë, 8 asistime dhe 11 "rebounde", ndërsa për Bostonin veçohet paraqitja e Evan Fournierit dhe Jayson Tatumit respektivisht me 30 dhe 29 pikë. Vjen fitorja e katërt radhazi e Dallas Mavericksit, që këtë herë dominoi në sfidën ndaj Cleveland Cavaliersit 97-124. As përjashtimi i të talentuarit sloven Luka Donçiq në fillim të periodës së tretë për



goditjen që i dha Collin Sextonit në pjesët e poshtme të trupit gjatë dyluftimit për kontrollin e një topi, nuk e vuri në diskutim suksesin e skuadrës teksane. Shënuesi më i mirë rezultoi Tim

Hardaway Jr. me 25 pikë, raporton "Supersport". Fiton në transfertë edhe New York Knicksi, duke iu imponuar Los Angeles Clippersit 100-106, rezultat që i blinton njujorkezët në zonën "play-off". Vendimtarë me kontributin e tyre Derrick Rose me 25 pikë dhe Reggie Bullock me 24, ndërsa të zotëve të shtëpisë nuk u mjaftuan 29 pikët e Kawhi Leonardit. Vjen humbja e tretë radhazi për Orlando Magicun, që u dorëzua pa kushte përballë Minnesota Timberwolvesit 96-128. Më të mirët mbi parket rezultuan D'Angelo Russell dhe Karl-Anthony Towns me nga 27 pikë.

REZULTATET

Boston - Miami	124-130
LA Clippers - New York	100-106
Charlotte - New Orleans	110-112
Cleveland - Dallas	97-124
Orlando - Minnesota	96-128
Detroit - Chicago	96-108
LA Lakers - Phoenix	123-110
Sacramento - Oklahoma	126-98

Zidane: Jam i zëmëruar me gjyqtarët

Madrid, 10 maj - Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka thënë se ndihet shumë i zëmëruar për shkak të një vendimi kontrovers të VAR-it që shkoi kundër skuadrës së tij në barazimin zhgënjës 2-2 me Sevillën të dielën, i cili ia mohoi Realit kalimin në krye të La Ligës. Gjatë rishikimit në ekranin e VAR-it të një penalltie të fituar nga Karim Benzema, gjyqtarët erdhën në përfundim se gjatë një aksioni paraprak në pjesën tjetër të fushës kishte prekje të topit me dorë në zonë nga mbrojtësi i Real Madridit, Eder Militao. Në vend se Real Madridi të fitonte penallti, gjyqtari akordoi penallti për Sevillën. Ivan Rakitiq shënoi dhe e kaloi skuadrën e tij në epërsi



prej një goli, para se Eden Hazardi ta barazonte rezultatit në fund të kohës shtesë. "Nuk më ka bindur ajo që më thanë gjyqtarët", ka thënë Zidane. "Jam shumë i zëmëruar. Bisedova me gjyqtarin në kërkim të një shpjegimi. Është shumë se koklavitur sepse ne merituum shumë më shumë, por ndodhi çka ndodhi", ka shtuar ai. Ndërsa

në konferencë për media, trajneri francez ka deklaruar: "Nuk kuptoj asgjë nga gjyqtari. Nëse Militao e preku topin me dorë, atëherë edhe dikush nga Sevilla e bëri. Nuk më bind ajo që ma thanë ata. Unë kurrë nuk flas për gjyqtarët, por sot jam i zëmëruar. Mos më pyetni më për këtë. Ne do të luftojmë deri në fund, deri në vdekje".

SHKURT

Behrami mes pensionimit dhe vazhdimet me Genoan

Valon Behrami po mendon t'i japë fund karrierës futbollistike. Mesfushori nga Kosova që aktivizohet me skuadrën italiane Genoa nuk është i sigurt sa i përket të ardhmes në futbollin aktiv. Mediat në Itali kanë raportuar se Behrami po mendon seriozisht tërheqjen nga futbollit në fund të këtij edicioni. Por ish-reprezentuesi i Përfaqësueses së Zvicrës ka pranuar së fundmi një tjetër ofertë nga skuadra aktuale Genoa për vazhdimin e kontratës. Genoa i ka ofruar një tjetër kontratë njëvjeçare, pasi drejtuesit e klubit vazhdojnë të besojnë në aftësitë e shqiptarit. Përkundër se tanimë është 35-vjeçar, Behrami këtë edicion ka zhvilluar 24 ndeshje në Serinë A, ku ka bërë edhe një asistim. Gjithsesi lojtari ende nuk ka marrë vendimin përfundimtar dhe pas përfundimit të sezonit pritet të vendosë nëse do ta përfundojë karrierën apo do të bindet për të vazhduar edhe një vit me Genoan në Serinë A.

Lëndohet Ibra, rrezikon pjesëmarrjen në 'Euro 2020'

Sulmuesi Zlatan Ibrahimoviç u lëndua në ndeshjen që Milani e fitoi kundër Juventusit (0-3). Ibrahimoviç pas rrëzimit vazhdoi lojën edhe pak minuta, ndërsa u zëvendësua nga Ante Rebiç. Suedezi po luftonte për një top kur dëmtoi gjurin, shkruan "Goal". Synimi i Ibrahimoviçit pa dyshim se ka qenë që të luajë në "Euro 2020" këtë verë. Por, nga ky lëndim nga i cili nuk dihet se kur mund të rikuperohet sulmuesi mund t'ia rrezikojë paraqitjen me kombëtaren e Suedisë.

Mourinho e kërkon Iscon te Roma

AS Roma është futur në garë për kartonin e Iscos, i cili me shumë mundësi do të largohet nga Real Madridi gjatë afatit kalimtar të verës. Trajneri i ri i Romës, Jose Mourinho, u ka kërkuar drejtuesve përforsime për mesin e fushës derisa në listë është 29-vjeçari që vlerësohet 20 milionë euro. Drejtuesit e Romës kanë dhënë miratimin për afrimin e mesfushorit, duke parakaluar "Zonjën e Vjetër" në tratativat për blerjen e futbollistit gjatë afatit kalimtar të verës.

Pirlo, afër shkarkimit

Skuadra e Juventusit pësoi një humbje të madhe kundër Milanit (0-3) dhe tani janë shanset të mos e sigurojë kualifikimin në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm. Trajneri Andrea Pirlo mori bardhezinjtë në verën e shkuar, por aventura e tij si trajner nuk ka shkuar aspak mirë dhe shkarkimi mund të vijë më shpejt seç ishte menduar. "Corriere dello Sport" raporton se Pirlo do ta lë këtë javë skuadrën dhe ndaj Sassuolos të mërkurën do ta drejtojë Igor Tudor, zëvendësi i tij.

Tuchel: Do ta mposhtim Cityn në finale të Ligës së Kampionëve

Trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel, është optimist se mund ta mposhtë Manchester Cityn në finalen e Ligës së Kampionëve. Tuchel e ka mposhtur Pep Guardiolen në dy përballjet e fundit brenda një muaji, në gjysmëfinalen e Kupës FA në 17 prill dhe më 8 maj në

kampionat. "Çfarë paraqitjeje në pjesën e dytë. Ishte një pjesë e parë pak a shumë e ekuilibruar, por ne për pak sa nuk e humbëm ndeshjen në 5 minutat e fundit. Nëse ata do të kishin shënuar atë penallti, ndeshja do të kishte përfunduar me 2-0. Ne merituum të fitojmë në

pjesën e dytë. Nëse do të fitosh 3 pikë në 'Etihad', sigurisht që duhet të kesh edhe fat edhe në vendimet e arbitrit. Është një fitore që na jep besim për finalen, por ky rezultat nuk do ta vendosë atë. Finalja është një ndeshje unike dhe nuk e parashikon dot se çfarë do të ndodhë.

Duhet të jemi mirë të përgatitur. Do të bëjmë disa ndryshime sërish, ata gjithashtu, por ne do të mbërrim atje duke ditur se jemi të aftë për ta mundur Cityn. Kjo është ndjesia që kemi tani dhe nuk do të ndryshojë deri në Stamboll", ka thënë Tuchel.



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar në nenin 110, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, nenit 20 dhe 21 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe nenit 8 të Rregullores nr. 07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe Vendimin KPK/Nr. 247/2021 të datës 27 prill 2021, rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për rekrutimin e gjashtëmbëdhjetë (16) prokurorëve të shtetit në nivel të prokurorive themelore të Republikës së Kosovës:

1. Katër (4) pozita për Prokurorë të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
2. Katër (4) pozita për Prokurorë të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjakovë;
3. Tre (3) pozita për Prokurorë të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj;
4. Dy (2) pozita për Prokurorë të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Pejë;
5. Dy (2) pozita për Prokurorë të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjiilan;
6. Një (1) pozitë për Prokuror të Shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PROKURORËVE TË SHTESTIT

Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë:

1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale në pajtim me ligjet e aplikueshme dhe kodin e etikës profesionale;
4. të ruaj nderin dhe dinjitetin e Prokurorit të Shtetit;
5. të mbrojnë të drejtat e viktimave, dëshmitarëve, të dyshuarve, të akuzuarve dhe të personave të dënuar;
6. të ndërmarrë veprime të nevojshme ligjore për zbulimin e veprave penale dhe zbulimin e autorëve të krimit, dhe po ashtu hetimin dhe ndjekjen penale me kohë të veprave penale;
7. të marrë vendime për inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar që kanë kryer vepra penale;
8. të ngrejë aktakuza dhe t'i paraqes ato para gjykatës;
9. të ushtrorë mjete juridike të rregullta dhe jashtëzakonshme ndaj vendimeve të gjykatës;
10. të bashkëpunojë me policinë, gjykatat dhe institucione tjera;
11. të ndërmarrë të gjitha veprimet tjera siç specifikohen me ligj.

KRITERET LIGJORE TË KËRKUARA

Neni 7 të Ligjit nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit parasheh:

7.1. Kandidatët për emërim për prokurorë të shtetit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. të ketë diplomën e Fakultetit Juridik, të vlefshme në Kosovë;
3. të ketë kryer Provimin e Jurisprudencës, të pranuar sipas Ligjit të aplikueshëm në Kosovë;
4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;
5. të mos jetë i/e dënuar për një veprë penale;
6. të ketë së paku tri (3) vjet përvojë në fushën juridike, dhe
7. të ketë kaluar Provimin për Prokuror, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.

7.2. Për qëllime të këtij neni, përvoja në fushën juridike përfshin përvojën në çështje juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përvojën si noter dhe përmbarues privat.

APLIKIMI ONLINE

Kandidatët do të kenë mundësinë të aplikojnë vetëm përmes sistemit online, i cili do të jetë në dispozicion nga data **11 maj 2021 deri më 25 maj 2021** në linçet e veçanta, të cilët do të vendosen në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit ose direkt nga linkun si në vijim:

Klikoni këtu për t'u ridrejtuar te platforma online

Mënyra e vetme e aplikimit do të jetë përmes platformës online në linkun si më sipër.

Për informacione për mënyrën e regjistrimit dhe aplikimit, ju mund ta shkarkoni DORACAKUN nga platforma online.

VËREJTJE: Të gjithë kandidatët, të cilët janë njoftuar se plotësojnë kriteret ligjore për konkursin për prokurorë, të shpallur sipas Vendimit KPK/nr.237/2020 më datën 22 maj 2020, konsiderohet se kanë aplikuar edhe në këtë rishpallje dhe nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri.

DOKUMENTET E OBLIGUESHME SIPAS NENIT 8 TË RREGULLORES NR. 07/2015 PËR REKRUTIMIN, PROVIMIN, EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E PROKURORËVE TË SHTESTIT (Rregullorja)

Kandidatët obligohen që të bashkëngjisin origjinalin e skenuar të dokumenteve të listuara më poshtë OSE kopjet e vërtetuara/noterizuara si vijon:

- Çertifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Diplomën e Fakultetit Juridik, të vlefshme në Kosovë;
- Çertifikatën e vlefshme mbi dhënien e Provimit të Jurisprudencës;
- Çertifikatën që vërteton se kandidati nuk është i dënuar për veprë penale, siç është caktuar me ligjet në fuqi;
- Dëshminë mbi përvojën e punës siç është përcaktuar me ligj.

Dokumentet origjinale nëse kërkohen duhet t'i dorëzoni gjatë fazës së intervistës.

Dokumente shtesë

Po ashtu, sipas nenit 8, paragrafi 5 i Rregullores nr. 07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, kandidatët duhet të bashkëngjisin informatat e siguruar nga punëdhënësi **për tre (3) vjetët e fundit të përvojës profesionale**, të cilat përfshijnë:

- përshkrimin e detyrave të punës;
- performancën profesionale;
- masat eventuale disiplinore dhe
- çështje të tjera që konsiderohen relevante, të shoqëruara me dokumente mbështetëse, për vlerësimin e integritetit personal dhe aftësive profesionale, siç parashihen edhe me nenin 20 të Ligjit për KPK-në.

Në qoftë së informata që duhet të dorëzohet nuk është në dispozicion apo plotësisht në dispozicion për periudhën trevjeçare, duhet të bashkëngjitet një deklaratë e nënshkruar, në të cilën përfshihet referenca e përvojës relevante profesionale dhe arsyet e mosdorëzimit të informacionit të punëdhënësit me dokumente relevante mbështetëse.

Kandidati po ashtu duhet të bashkëngjisë, nëse i ka në dispozicion, dokumente ligjore profesionale apo akademike, apo publikime, të kryera krejtësisht nga kandidati (maksimumi tri); informacionin për pjesëmarrje në forma të organizuara të trajnimit në të cilën është vlerësuar performanca (maksimumi tri).

NJOFTIM I RËNDËSISHËM PËR KANDIDATË

Sipas nenit 9, paragrafi 3 i Rregullores nr. 07/2015 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e shpallura për pozitën për të cilën aplikojnë, jo më vonë se data e përcaktuar në Konkursin Publik.

KPK-ja informon të gjithë kandidatët që Komisioni për Rekrutim do të bëjë verifikimin e dokumenteve dhe deklaratave të dorëzuara për të mbështetur aplikimin.

KANDIDATËT TË CILËT NUK I KANË BASHKËNGJITUR DOKUMENTET E KËRKUARA BRENDA AFATIT, APLIKIMI I TYRE NUK DO TË MERRET PARASYSH

Neni 37, paragrafi 3 i Rregullores 07/2015 parasheh se kandidatët, të cilët e kanë përfunduar provimin dhe trajnimin fillestar, të organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës do t'i nënshtrohen vetëm Intervistës me Gojë, procesit të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të kandidatëve, siç është e përcaktuar edhe me nenin 23 dhe 24 të kësaj rregulloreje.



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council



Tužilački Savet Kosova na osnovu člana 110 stav 2 Ustava Republike Kosova, člana 7 stav 1 podstav 1.6, člana 20 i 21 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, člana 7 Zakona Br. 05/L-034 o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-225 o Državnom Tužiocu i člana 8 Pravilnika Br. 07/2015 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Ponovnom Imenovanju Državnih Tužilaca kao i Odluke TSK/Br. 247/2021 datuma 27 aprila 2021, ponovno objavljuje:

JAVNI KONKURS

O rekrutovanju šestnaest (16) Državnih Tužilaca u nivou osnovnih tužilaštva Republike Kosova:

1. Četiri (4) pozicije za Državne Tužioce u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Prištini;
2. Četiri (4) pozicije za Državne Tužioce u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Đakovici;
3. Tri (3) pozicije za Državne Tužioce u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Uroševcu;
4. Dve (2) pozicije za Državne Tužioce u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Peći;
5. Dve (2) pozicije za Državne Tužioce u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Gnjilane;
6. Jedna (1) pozicija za Državni Tužiocu u Opštem Departmanu Osnovnog Tužilaštva u Mitrovici;

OBAVEZE I ODGOVORNOSTI DRŽAVNIH TUŽILACA

Obaveze i nadležnosti Državnih Tužilaca uključuju:

1. Obavljanje tužilačkih funkcija na nezavisano, pravdano, objektivno i nepristrasno način, i obezbediti da se sve osobe podjednako tretiraju pred zakonom;
2. Sprovođenje visokih standarda pažljivosti tokom obavljanja službenih funkcija;
3. Pošteno i profesionalno ponašanje kao u ličnom tako i u profesionalnom životu u skladu sa primenjenim zakonima i u kodeksu profesionalne etike;
4. Da sačuva čast i ugled Državnog Tužioca;
5. Da zaštiti prava žrtava, svedoka, osumnjičenih, optuženih i kažnjenih lica;
6. Da preduzme potrebne zakonske radnje za otkrivanje krivičnih dela i otkrivanje autora kriminala i takođe istragu i blagovremeno krivično gonjenje krivičnih dela;
7. Da donosi odluke za iniciranje, nastavljnje ili prekidanje krivičnog postupka postupkaprotiv osumnjičenih ili optuženih lica koji su izvršili krivično delo;
8. Da podigne optužnice i da to predstavlja pred sudom;
9. Da podnese redovne i vanredne pravne lekove protiv sudskih odluka;
10. Da saraduje sa policijom, sudovima i ostalim institucijama;
11. Da preduzme sve ostale radnje kao što se specifikuje zakonom.

TRAŽENI ZAKONSKI KRITERIJUMI

Član 7 Zakon Br. 05/L-034 o Izmenama i Dopunama Zakona Br.03/L-225 o Državnom Tužiocu predviđa:

7.1. Kandidati za imenovanje za Državnog Tužioca treba ispuniti sledeće uslove:

1. da bude državljanin Republike Kosova;
2. da poseduje diplomu pravnog fakulteta koja je važeća na Kosovu;
3. Da ima završen pravosudni ispit, priznat na osnovu primenjenog Zakona na Kosovu;
4. Da ima visoku profesionalnu reputaciju i lični integritet;
5. Da ne bude kažnjen/a za neko krivično delo;
6. Da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva iz pravne oblasti; i
7. Da ima položen ispit za tužioce u skladu sa uslovima i procedurama koje su određene posebnim opravilnikom koji je usvojen od strane Saveta.

7.2. U svrhu ovog člana iskustvo iz pravne oblasti uključuje iskustvo iz pravnih pitanja u domaćim i međunarodnim institucijama i organizacijama, iskustvo kao noter i privatni izvršilac.

APLICIRANJE ONLINE

Kandidati će imati mogućnost da apliciraju samo preko online sistema koji će biti na raspolaganju od **11 maja 2021 do 25 maja 2021** preko posebnog linka koji će biti postavljen u službenoj veb stranici Tužilačkog Saveta Kosova i Državnog Tužioca ili direktno na sledećem link-u:

[Kliknite ovde da bi se preusmerili na online platformu](#)

Jedini način apliciranja biće preko online platforme na gore navedenom linku.

U vezi informacija o načinu registrovanja i apliciranja vi možete preuzeti RUKOVNIK sa online platforme.

Svi kandidati koji su obavesteni da ispunjavaju pravne uslove za konkurs za tužioce objavljeno dana 22 maja 2020 na osnovu Odluke TSK/Br.237/2020, smatraće se da su aplicirali i u ovom ponovnom konkurs i nemaju potrebu da ponovo apliciraju.

OBAVEZNA DOKUMENTA NA OSNOVU ČLANA 8 PRAVILNIKA BR. 07/2015 O REGRUTOVANJU, ISPITU, IMENOVANJU I REIMENOVANJU DRŽAVNIH TUŽILACA

Obavezuju se kandidati da prilože skenirani original dole navedenih dokumenata ILI overene/noterizovane kopije kao što su:

- Uverenje o državljanstvu Republike Kosova;
- Diplomu Pravnog Fakulteta koja je važeća na Kosovu;
- Važeću potvrdu o polaganju pravosudnog ispita;
- Potvrdu koja potvrđuje da kandidat nije kažnjen za krivično delo, kao što je određeno pravosnažnim zakonima;
- Dolaz o random iskustvu kao što je određeno zakonom;

Originalni dokumenti ako budu traženi dostaviće te tokom faze intervju.

Dodatna dokumenta

Takođe na osnovu člana 8 stav 5 Pravilnika br. 07/2015 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Reimenovanju Državnih Tužilaca, kandidati treba priložiti obezbedene informacije od poslodavca **za poslednje tri (3) godine profesionalnog iskustva** koje uključuju:

- Opis radnih obaveza;
- Profesionalnu performansu,
- Eventualne disciplinske mere i
- Ostala pitanja koje se smatraju relevantnima, uz dodatnu dokumentaciju o vrednovanju ličnog integriteta i profesionalnih sposobnosti kao što se predviđa članom 20 Zakona o TSK-a.

Ukoliko informacija koja se treba dostaviti nije na raspolaganje ili potpuno na raspolaganje za trogodišnji period, treba se priložiti jedna potpisana izjava u kojoj su uključene referense o relevantnom profesionalnom iskustvu i obrazloženja o nedostavljanju informacije poslodavca sa dodatnim relevantnim dokumentima.

Kandidat takođe treba priložiti, ako poseduje, profesionalna pravna ili akademska dokumenta ili publikacije, obavljenje potpuno od strane kandidata (maksimum tri); Informaciju o učešću u organizovanom obliku obuke u kojoj je ocenjena performansa (maksimum tri).

VAŽNO OBAVEŠTENJE ZA KANDIDATE

Na osnovu člana 9 stav 3 Pravilnika Br. 07/2015 o Regrutovanju, Ispitu, Imenovanju i Reimenovanju Državnih Tužilaca, kandidati treba ispuniti kriterijume koji su objavljeni za poziciju za koju apliciraju, ne kasnije od određenog datuma u Javnom Konkursu.

Tužilački Savet Kosova obaveštava sve kandidate da Komisija za Regrutovanje vrđiče verifikaciju dokumenata i izjava koje su dostavljene da bi podržale apliciranje.

TAKOĐE, KANDIDATI KOJI NISU U ROKU PRILOŽILI TRAŽENE DOKUMENTE, NJIHOVA APLIKACIJA BIĆE ODBIJENA.

Član 37 stav 3 Pravilnika 07/2015 predviđa da kandidati koji su završili ispit i početnu obuku koja je organizovana od strane Kosovskog Instituta za Pravosuđe biće podvrgnuti samo usmenim intervjuu, procesu vrednovanja ličnog integriteta i profesionalnih sposobnostima kandidata, kao što je određeno članom 23 i 24 ovog Pravilnika.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 5353/20 të datës 30.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fiton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:
 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
 Suzana.goranci@rks-gov.net
 Telefon: + 381 38 200 32 553

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kushtim Elshani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Lekë Dukagjini " Prizren.
- ▶ Fitore Qatani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlle " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Berat Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlle " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Hasan Maloku shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

